

INTERVISTË ME VETON NURKOLLARIN

Prizren | Data: 28 gusht, 2018

Kohëzgjatja: 120 minuta

Të pranishëm:

- Veton Nurkollari (i Intervistuari)
- Aurela Kadriu (Intervistuesja)
- Donjeta Berisha (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Aurela Kadriu: Po ja nisim tu e prezantu veten ju edhe nëse mundeni veç me m'tregu diçka për kujtimet e hershme të fëmijërisë? Çfare ka qenë familja në të cilën jeni rritë edhe rrethi në të cilin jeni rritë?

Veton Nurkollari: Okej. Unë jam Veton Nurkollari, nga Prizreni. Kam lind në vitin 1962, këtu në Prizren. Në një familje, ku babën e kam pasë fotograf, nanën mësuse dhe në një shtëpi familjare ku përveç familjes tonë kanë qenë shtëpitë edhe të axhës dhe dy djemve të axhës babës. Kështu një shtëpi pak ma e madhe {hap duart} me shumë fëmijë, me një oborr shumë të madh, me plot ato që i quajme këtu ne kapixhka, derëza, dyer të vogla ku ke mujt me dalë prej një shtëpie në shtëpi tjetër, njëfarë rrjeti i, i lëvizjes që ka qenë shumë interesante, që nuk ekziston më. Qeto jonë do kujtime të hershme, kemi luft shumë edhe kemi luft në oborr edhe kemi luft me, me fëmijë, kushëritë, vllazërit, motrat, djem të axhës, vajza të axhës në atë oborr prej lloj-lloj lojnave dej te futboll e, e disa lojëra tjera që edhe ato me gjasë janë zhduk tash e nuk i shoh mo me luft. Po, ka qenë një fëmijëri kështu pa brenga, një fëmijë me plot gëzim, hare, lojna. Qysh thashë, këto janë disa kujtime që i mbaj në mend, prej të them kështu fëmijërisë të hershme.

Aurela Kadriu: A keni qenë fëmijë i vetëm në familje apo keni pasë edhe...?

Veton Nurkollari: Jo, unë kam një motër edhe një vëlla, ashtu që kemi qenë tre fëmijë. Në atë shtëpinë e madhe ka pasë së paku edhe... po, jo më pak se edhe dhetë fëmijë të tjerë. Kështu që, kemi qenë një ushtri e vogël e, e fëmijëve pak a shumë të moshës {ul dhe ngritë duart} ngjashme. E mbi ato pastaj prej një, prej një farefisnija ma të madhe, nana ime i ka edhe pesë motra të tjera edhe shumë fëmijë edhe shumë nga ato vajzat dhe djemtë e tezës, e të hallave, e të dajve kanë qenë shpesh te na, në atë oborrin e madh. Kështu që, po them, gjithmonë fëmijë ka pasë, gjithmonë, gjithmonë lojë ka pasë, gjithmonë njëfarë gëzimi, hareje.

Nuk ka pasë... ka qenë një oborr i madh, i hapun {hap duart}. Tash në atë shtëpi janë disa mure, është njëfarë zhvillimi i asaj se si prej një oborri {hap duart} apo një familje të madhe dalë-ngadalë reduktohet në {afon duart}, në, në disa mikro familje ma të vegjël, po kur ndërtohen disa mure, qasja pengohet, kështu që nuk ekziston më ai oborri. Fizikisht është aty, mirëpo tash ekzistojnë disa mure, disa dyer

është shumë ma problematike tash edhe qasja, që atëherë ka qenë kështu e hapur, e ka pasë vend për me luft, kopsht ka pasë, domate, plot, spec, ku ta di une, plot sene ka pasë.

Aurela Kadriu: Cilën lagje keni jetu?

Veton Nurkollari: Unë kam jetuar dhe vazhdoj të jetoj në lagjen e njejtë e cila është, quhet Bazhdarhane ose fillimi i Bazhdarhanes. Në një lagje që tash është pak a shumë qendra e qytetit, por në atë kohë nuk ka qenë as periferi, po nuk ka qenë as ndonji qendër, kështu ta qujmë. Ka qenë pak ma, ma, ma e qetë se tash, nuk ka pasë qarkullim sa ka tash. Po ka qenë një lagje mes qytetit, ende vazhdoj të jetoj aty.

Aurela Kadriu: Çfarë lagje ka qenë në kuptimin e popullatës, po më intereson?

Veton Nurkollari: Po për shkak të afërsisë të një objekti i cili tash është selia e kryetarit të Komunës, e që në atë kohë ka qenë një objekt që i takonte ushtrisë së Jugosllavisë dhe në afërsi të atij objekti dhe përballë, bash përballë shtëpisë ku banoj dhe ku kam banu është një kompleks i ndërtesave të ushtrisë në atë kohë, të atëhershme, të oficerëve që kanë jetu aty. Lagjja ka pasë një përbëmje mikse, për asye që ka pasë mjaft sërbe por edhe sllovenë e boshnjakë, varësisht se cilët oficerë kanë shërby në atë kohë në, në ushtrinë e Jugosllavisë. Ashtu që, neve na ka ra pak me u shoqnu edhe me fëmijët e këtyne oficerëve, ashtu m'ka ra mu për shembull me mësu gjuhën.

E po ashtu më ka ra me kalu shumë kohë në atë objektin e ushtrisë, i cili ka qenë një objekt tejet interesant, sepse ka qenë i vetmi objekt për shembull që ka pasë bazen (buzëqesh) brenda. Ka pasë disa lojna tenis, *table tennis* [ping pongu] qysh me thonë tenis të tavolinës, që nuk ka pas gati askund. Dhe ne meqenëse kemi jetu aty dhe i kemi njoft disa ushtarë e kemi pasë një qasje të privilegjume, kemi mujt najherë gjatë verës me, me hi edhe me u la në bazen. Kemi hi me pa oficerët si lujnë në *bowling*, ka pasë njifarë *bowling* interesant, primitiv. Këto jane disa kujtime të domethanë të interakcionit edhe me njerëz të tjerë, jo vetëm të lagjes apo të rrethit po edhe me disa njerëz që në pamje të parë kanë qenë pak ma ndryshe se na.

Po në anën tjetër edhe shkolla ku kam shku që ka qenë jo larg shtëpisë, ka qenë një shkollë mikse me shumë paralele edhe serbe edhe turke. Kështu që, edhe kjo çashtja e gjuhës edhe e, e si me qujt, mësimi të saj ka qenë diçka organike, normale, jo vetëm unë por shumica e moshatarëve të mi e kemi mësu gjuhën kështu rrugës.

Aurela Kadriu: Po më intereson, a ka qenë e zakonshme në Prizren në qat' kohë mi pasë dy prind profesionistë në fusha të caktume, a kanë qenë krejt familjet po meno, shumica e familjeve, a e kanë pas qet lloj konstrukt?

Veton Nurkollari: Jo, nuk jam i sigurt. Prej çka mbaj mend unë, prej shoqnisë apo, apo shkollës unë kam pasë shokë që të dy prindët [i kanë pasur] profesionistë, mjek për shembull, ose, ose, ose punëtor

në administrata të shtetit ose nëpër, s'po di gjyqësor. Ndoshta jo të dytë, por një pjesë e mirë e, e shokëve të mi dhe shoqeve të mija, kanë qenë profesionistë, kanë qenë njerëz që kanë qenë të inkuadrum nëpër punë të ndryshme, profesionistë të ndryshëm. Tash nuk e di une sa i përket për të dy prind, por shumicën e rasteve së paku një prind ka qenë profesionist, pra.

Aurela Kadriu: Baba fotografinë a e ka pasë ndjekje akademike apo e ka pasë zanat?

Veton Nurkollari: Jo zanat, baba e ka pasë zanat për shkak që në Kosovë nuk ka ekzistuar shkolla e fotografisë, nuk ekziston në fakt as, as sot. Po baba im ka mësuar zanat ndoshta te fotografisti ma i njoftun prizrenas, por jo vetëm prizrenas por edhe më gjërë, te Faik Sharri. Një profesionit dhe një patriot i jashtëzakonshëm, moshatar dhe mik i Ibrahim Fehmiut, babës së Bekim Fehmiut. Ka mësuar dhe deri në momentin kur Faik Sharri ka emigruar në Turqi, ka qenë punëtor. Dhe në momentin kur Faiku me familjen janë shpërngulë, kanë emigruar në Turqi, baba im e ka trashëguar në një formë edhe titullin edhe firmën e, e, e ashtu qujatur Foto Sharri dhe e ka vazhduar deri, deri gati në, në vdekje. Po në ndërkohë, baba im ka diplomë për fotograf dhe e ka pasë diplomën në vitin 1957 si fotografist i diplomuar edhe pse ajo nuk ka qenë diplomë çfarë mirrë sot nga shkollat, por nga një... diçka ndërmjet kursit dhe praktikës, ku ka pasë të drejtë para një ekipi profesionist të dëshmosh aftësitë dhe ta fiton diplomën dhe ka pasë një diplomë {me duar tregon madhësinë} më kujtohet nga viti 1957.

Aurela Kadriu: A ka pasë shumë kamera, shumë fotografi në shtëpi të ju?

Veton Nurkollari: Po, ka pasë kamera natyrisht (buzëqesh). Kamera, aparate, çdo gjë që, që ka të bëjë me fotografi. Po një ndër kujtimet e hershme të mia e që ka të bëjë me fotografi, ka qenë në fakt një gjë që kam pa vetëm atëherë edhe për një kohë të shkurt deri... tash nuk më kujtohet sakt, po baba vinte në shtëpi, e ka pasë njëfarë kutie të madhe {shpjegon me duar} me një pesëshe në atë kuti, pastaj kam kuptuar që ajo kuti ka qenë kuti e do bomboneve, po kuti e madhe e metalit, kaq diçka {tregon me duar madhësinë} e brenda saj do shishe të vogla, edhe, edhe do qese të vogla, në secilën prej tyre ka pasë do kemikate. Pluhur të ngjyrave të ndryshme, të cilat ai me një perfeksionizëm secilën herë e matke.

E ka pasë një, një vagë [peshore] të çuditshme, edhe atë vagë e mbaj në mend {shpjegon me duar formën} një vagë në të cilën ai i vendoske do copa të letrës për me mat, së paku një dhetë, ndoshta edhe ma shumë përbamje të kemikateve diçka shumë pak, diçka shumë ma shumë. E mandej ato një nga një i përzinte {bën sikur përzien diçka me dorë} për me fituar një solucion të cilin mandej e përdorte për zhvillim të fotografive dhe të filmit. Alkemi! Mu m'u doke si, si, si një nuk e di qysh me kujt. Nuk, nuk... si fëmijë nuk e kam pasë të qartë çka, çka po ndodh aty. I matte diçka një, dy, tre, katër {sikur ndan diçka} mandej një nga një deri sa u tretshin {sikur derdh dhe përzien diçka} njëherë e tretë të parin, mandej të dytin, mandej të tretin.

E ka pasë një libër {me duar bën sikur hap dhe shfleton} në cilën, secilën herë u konsultojke se sa gram për cilin kemikat për me bo solucione e ato, libri po ashtu ka qenë pjesë e asaj kutisë të madhe, mrena

ka qenë (qesh), me do shënime. Mandej, masi dolën të gatshme këto solucionet atëherë s'ka pasë nevoj mo, po kjo është një, një prej memorjeve që më kujtohet e që kanë të bëjnë, memorjet e para që kanë të bëjnë me fotografinë. Po ashtu më kujtohet shpesh që fotografitë e gatshme i sjellte në shpi, për me e bo atë lamjen e fundit edhe për me i terë, nuk i terte në, në lokal për shkak se makina, ka qenë njëfarë makine, një terëse dy anëshe {shpjegon me duar} në të cilat u ngjithshin fotografitë dhe pastaj si bukën me pjek diçka (buzëqesh).

Qeto janë memorjet e para që kanë të bëjnë me fotografi. Para se unë t'ja nis ta vizitoj lokalin e tij, njëfarë lloj pjesë e, e punës tij që kom vazhdu mandej me qenë për një kohë të gjatë.

Aurela Kadriu: E nana, nana çfarë ndikimi ka pas duke qenë mësuse?

Veton Nurkollari: Nana, nana ka qenë mësuse një kohë tejet të shkurtër, unë nuk mbaj mend kur ka qenë ajo mësuese. Ka qenë mësuese në Suharekë në shkollën fillore për një kohë të shkurt. Unë vetëm kam ndëgju për shkak që dajën, vëllaun e nanës e kam pasë profesor të matematikës, njëherë mësues pastaj profesor të matematikës, për një kohë të gjatë në shkollën teknike këtu. Po kam ndëgju nga daja, nana nuk tregonte shumë. Thoshte, "Po, atëherë baba më ka lutë vëllaun provo gjej naj punë". Po ka punu si mësuese ende para se me u martu që ka qenë një, një edhe një send tepër i rrallë për, për kohën, vitet e '50-ta me siguri. Domethanë, dikun '55 para vitit, para, para '60-tave sepse është martu në fund të '50-tave.

Aurela Kadriu: Pse ka punu aq shkurt, ndoshta... a veç zgjedhje kështu e kohës?

Veton Nurkollari: {ngrit supet} Nuk jam i sigurt (buzëqesh), nuk jam i sigurt, po e di që ka punu një kohë të shkurt si, si mësuese. Mandej kur është martu ka qenë amvise edhe domethanë tanë jetën është kujdesë për neve, për shtëpinë. Një nanë, si shumica e nanave, që janë tepër të dhanun për fëmijët e vet edhe ashtu.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë për juve, unë e di që në atë kohë ka qenë shumë, shumë interesant që kanë lujt kryesisht në zona ma të mbylluna, qysh ka qenë zona publike për juve, a keni dalë najhere në lagje, përtej oborrit?

Veton Nurkollari: Po

Aurela Kadriu: Qysh u konë në lagje?

Veton Nurkollari: Po, kemi dalë në lagje. Lagjja ka qenë interesant, pak ma ndryshe se që është tash. Ka pasë, në fakt po më duket që ka pasë ma shumë hapësinë për me lujt se tash. Se tash pjesa para shtëpisë është njëfarë parku i cili gravitohet nga plot njerëz, mirëpo unë nuk shoh fëmijët me lujt aty. Ndoshta ka ndryshu shumë, na kemi lujt shumë, domethanë prej oborrit kemi dalë edhe, edhe ka qenë

si një, ta quaj oborr i madh i lagjes, një edhe shumë afër edhe një hapsinë tjetër që është gati si një shesh, gjysëm i mbyllun. Shumica e njerëzve në Prizren nuk e dijnë, por ka qenë një shesh i bukur, me një treg në qendër të sheshit dhe ka qenë tregu i, i vetëm i Prizrenit për bylmet, për djath, e qumësht, e prodhimet e bylmetit.

Edhe rreth atij tregut ka qenë tregu i pemëve dhe i perimeve, u shitshin rrugëve edhe të mërkureve u bojke një tollovi e madhe, një hallakamë, vijshin njerëzit me ble. E ne kishim pasë shumë qef qatje m'u sillë ku ka shumë njerëz, e me luft (buzëqesh) e me kqyrë gjithë atë tollovinë. Kështu që, plus qajo ndërtesa e, e oficerëve të armatës ka qenë edhe një vend tjetër. Ashtu që, kena pasë mjaft vend për, për me luft. Mbi krejt këto ka qenë edhe hapësina e shkollës, që ka qenë shumë afër shtëpisë që kur kena dashtë me luft futboll e qesi sene, kena shku në shkollë kena luft (qesh). Kemi pasë mjaft vend sa më kujtohet.

Aurela Kadriu: Kur keni shku në shkollë fillore dhe ku?

Veton Nurkollari: Kam shku në shkollën fillore që është quaj atëherë "17 Nëntori", e që është, nuk e di 300-400 metra nga shtëpia ku banoj, por me një rrugë që të çon ndoshta pak më gjatë. Por, prapë kemi pasë do, do shkurtesa prej një shtëpie, në shtëpi tjetër, në shtëpi tjetër edhe me dalë në shkollë menjëherë. Kështu që, i kemi shfrytëzuar këto (qesh), po relativisht afër ka qenë.

Aurela Kadriu: Kur pi bjen '68-'69-tën?

Veton Nurkollari: Unë kom shku në shkollë prej '68-tës deri '76-tën, po.

Aurela Kadriu: Çka kujtoni prej shkollës fillore? Po menoj e keni nis shkollën fillore '68-tën që është njëfarë viti karakteristik, shumë interesant.

Veton Nurkollari: Asgjë s'më kujtohet për atë '68-tën (qesh)

Aurela Kadriu: Natyrisht po, veç kështu...

Veton Nurkollari: Prej atëherë më kujtohet njëfarë gëzimi për shkollë, e di që jam gëzu shumë, por nuk e di as pse por krejt ajo në lidhje me shkollën m'u ka dok shumë interesant edhe shumë menxi pritsha me shku çdo ditë në shkollë. Me siguri për shkak që dojsa me luft, jo që ka qenë diçka në lidhje me, me, me mësimet e senet, ato me gjasë kanë ardhë pak ma vonë. Po ka qenë një pjesë, domethanë në ato vitet ka qenë shumë benin ta quj kështu, pa, pa naj sherr. Nuk kena ditë na për gajlet e botës e çka po ndodh, atmosfera në vend ka qenë relativisht e qetë. Ashtu që, neve na u ka dok shumë mirë e shumë interesant e shumë... veç me luft, veç me bo, me qenë me shoqni, me, me... tu u rritë kadal-kadale. Fillimisht na çojke nana në shkollë dej sa, dej sa e mësum se qysh duhet me shku

(buzëqesh), vinte na pritje për me na kthy, mandej motra më çojke në shkollë, se ajo pak ma e madhe. Po ndërkohë nuk e di, në klasën e tretë e të katërt veç ja nisëm me shku vet e m'u kthy vet e, qashtu.

Aurela Kadriu: Çfarë funksioni ka pasë klasa, a janë konë klasët e ndame, domethanë shqiptarë, serbë, turq?

Veton Nurkollari: Po {pohon me kokë}.

Aurela Kadriu: A po, janë konë të ndame a?

Veton Nurkollari: Po në qat' shkollë ka pasë paralele të... shqipe, serbe edhe turke. Domethanë, qysh atëherë ka pasë paralele të ndame.

Aurela Kadriu: Ju keni mësu në shqip, a po?

Veton Nurkollari: Unë kam mësu në shqip, po.

Aurela Kadriu: E shkolla fillore zakonisht është një periudhë që s'është që mbahet mend shumë edhe është e çuditshme. Po, shkollën e mesme mandej, kisha dashtë me u kthy mandej qysh, kur ja keni nisë me shku me nejt në lokal te baba? Fillimisht po du me nejt pak te shkolla e mesme për shkak se është e rëndësishme. Po mundeni me vazhdu... qysh ka vazhdu?

Veton Nurkollari: Okej, shkolla e mesme... kështu, unë kam pasë dëshirë si një pjesë e, e mirë e atij grupit me të cilët kam qenë në shkollë me shku, ekskluzivisht me shku në gjimnaz. Ka qenë si, nuk e di si njëfarë arritje dhe kam shku vet jam regjistru në gjimnaz, jam pranë në gjimnaz edhe kur jena regjistru është dashtë menjëherë m'u regjistru në... se kanë qenë vetëm dy drejtime. Nuk ka pasë lloj-lloj drejtime, po është dashtë m'u orientu, a don me qenë në shkollë në drejtimin, ashtu u qujt gjuhësor apo, apo shkencor (buzëqesh)? Ashtu që shumica e madhe u regjistru në drejtimin shkencor, mandej dikush nuk ka mbërri për shkak të disa rezultateve, po unë e kam kry si një grup, pjesën e madhe të shokëve të klasës edhe shoqeve në drejtimin shkencor.

Në gjimnazin e atëhershëm i cili ka qenë, si najfarë Stanford University (qesh) najçka. Në atë kohë me të vërtetë cilësia edhe profesorët... tash s'po du me nënvlerësu çka është tash, por me siguri ka qenë shumë, shumë ma një nivel tjetër. Ashtu që, mu personalisht më ka ndihmu shumë komplet ajo kohë që e kam kalu në gjimnaz edhe disi më ka përmbush njëfarë forme nevojën për, për edukim. Ashtu që, kur kam shku në fakultet m'u ka dok tepër edhe menjëherë e kam lon fakultetin (buzëqesh). Dy herë kam tentu me studiu, dy herë i kam dhanë disa provime, por kam thonë që, nevojën për ma shumë edukim disi nuk më ka, nuk më ka dalë atëherë. Kam pasë njëfarë bindje që qaq sa kam dashtë kam mësu në gjimnaz (qesh). Edhe nuk jam pendu asnjëherë.

Aurela Kadriu: Naj kujtim ma specifik gjatë kohës gjimnazit, mendoj që kjo është periudha kur ja nis gjenerata e juv që e di se jeni një gjenratë me babin tem, gjimnazin e kanë një periudhë kur ja nis rokenrolli, ja nis...

Veton Nurkollari: Po, plot sene kanë nis në gjimnaz. Prej, prej, prej Beatles për shembull, e kam pasë një shok që ka qenë kështu Beatles fan i madh edhe, edhe na i sillshin pllakat edhe do gramafona dhe në klasë. Në pushim, nëse e kemi hup ndonji orë, na ndëgjojmë muzikë edhe në klasë qaty, këto janë disa kujtime. Nji kafi [kafene] është çelë shumë afër gjimnazit, ashtu që shpesh kemi ikë prej ndonji ore për me mujt me kalu kohën në kafi, me ngu muzike e... Nejat e para i kena bo nëpër shpija në kohën kur kena qenë në gjimnaz. Njëfarë, njëfarë lirie ose tentimi për me qenë sa ma i lirë ka lindë atëherë. Në shkollë fillore as nuk kam pasë nevoj, as nuk është shfaq ajo dëshira.

Mirëpo, dëshira për m'u rrebelu pak, për, për m'i ikë edhe do, s'po di normave edhe stigmave të familjes, edhe të shoqërisë kanë dalë në kohën e gjimnazit. Edhe kemi bo edhe sende të mira edhe sende jo bash të mira, por është periudha, periudha e njëfarë çlirimit. Edhe unë kam pasë fat që ato vitet kanë qenë vitet relativisht të qeta. Menjëherë masi që e kam kry une shkollën edhe kur kam shku ushtar ka nisë njëfarë, si me thonë, zanafilla e plot ndryshimeve edhe të them edhe përkeqësimit të situatës. Por, deri '80-tën kur unë e kam përfunduar shkollën e mesme ka qenë një kohë e pa brenga unë mund ta quaj. Të vetmet brenga na i kemi pasë qysh me bo ma mirë. Edhe kam shumë kujtime interesante prej gjimnazit sigurisht.

Aurela Kadriu: Çfarë kanë qenë qato nejat nëpër shpija, qysh i bojshit, qysh i organizojshit? (qesh)

Veton Nurkollari: (qesh) Po në fakt a u dashtë me i organizu nejat nëpër shpija pasi që nuk ka pasë traditë me bo neja diku jashtë, ka qenë diçka si heretike me dalë tash në kafi me bo. Ashtu-ashtu nuk ka pasë shumë kafiqa, nuk ke pasë ti vende, e u dashtë m'i bo do neja, dikush e ka pasë ditëlindjen, dikush ato, dikush këto. Ashtu që, kushdo që ka pasë ndonji vend vetëm u organizojmë blejshim do pije, muzikë, ftojshim njerëzit edhe u bojke *house party* [anglisht - ndejë në shtëpi]. Kanë qenë të njoftuna (qesh) ashtu nejat nëpër shpija, jo shumë vonë se asnjoni prej neve s'mujke me nejt tepër vonë, femnat sidomos. Po u bojshim bashkë e qishtë, nejat e zakonshme, muzikë, dikush me tentu me lujt me dikun {bashkon duart si në përfaqim}, ndonji simpati ki, e tash a me ju afër, a me folë e qysh me folë, e çka me i bo? (qesh) E kesi sene, pak si naiv për atë kohë, po qashtu kanë qenë kohat atëherë.

Aurela Kadriu: Çfare ka qenë muzika, përpos e përmendët Beatles po më interesojnë edhe bendet tjera, llojet e muzikës tjetër edhe çka ka përfaqësuar për juve atëherë, por edhe tash kur e kqyrni në retrospektivë?

Veton Nurkollari: Po kqyr atëherë neve, tash mu personalisht më ka interesu pak a shumë secila lloj muzikë. Janë, qysh me thonë, vitet e para të formësimit ashtu që nuk është që kemi ditë na shumë për Stones, Beatles apo... çfarëdo muzike që ka pasë na ka interesu. Qitu ku është Hotel Theranda {tregon

me gisht kahjen majtas} ka qenë njëfarë terase e cila nuk ekziston më, terasa ka qenë dikur e njoftun për shkak që ka pas *live* [anglisht - e gjallë] muzikë edhe na në mbramje kemi tentu se jo çdo herë na lejshin me hi. Ka qenë dikush te do shkallë aty na kqyrshin, “Jo, ju tepër të ri s’bon”, ndonjiherë me dikend u zhdërvjellshim e hishim për me ngu për shembull Lumnjansit ka qenë njëfarë bendi i, i, ndër bendet e para autokton të Prizrenit t’u performu pop edhe rok edhe diçka rokenroll. Njifarë, njifarë përzimje me [Luljeta Çekun](#) si vokaliste, Nijazi Bytyqin në kitarë, kush ka qenë edhe Dauti, i ndjeri Dauti në, në timpon, në *drums* [anglisht - bateritë] {bën sikur i bie baterisë}.

Edhe asi lloj muzike na ka interesu, deri sa nuk erdh interesimi për disko muzikë (buzëqesh). Disko muzika është një send interesant për kryeqytet, për shkak se këtu ka ekzistuar një diskotekë edhe nëpërmjet diskotekës jemi njoftu me disko muzikën. Edhe në vitet e fundit të ‘70-tave ka qenë bumi i disko muzikës, ashtu që na ma shumë e ma shumë jemi dasht e pa dashtë jemi fut në disko. Une shpesh, jo shpesh po shpejtë kam dal mandej prej diskos se kanë nis me m’interesu zhanret e tjera të muzikës, nga rok, nga punk e shumë, e shumë. Po në ato vitet, mund të them fundi i ‘70-tave na ka qu ma shumë, e ma shumë në disko muzikë. Edhe kena pas qef me vallëzu, me shku në disko, me lujt me atë muzikë po edhe kena nis mu interesu në do sene, ku ta di une plot do...

Për shembull, unë e mbaj në mend kur, kur ka dalë *Rapper’s Delight* që ma merr mendja është hip-hop kënga e parë në histori të muzikës [hip-hop]. Është... kur ka dalë ka qenë si disko, për shkak që nëpër diskoteka e lëshojshin (buzëqesh). Por, sot konsiderohet si, si kanga e parë, kanga e cila ka qit edhe rep edhe hip-hop në skenë. E kena pasë rastin, për shembull këtu m’i ngu, nëpër diskoteka. Jo nëpër, se vetëm një diskotekë ka pasë këtu.

Aurela Kadriu: Ku ka qenë kjo diskoteka?

Veton Nurkollari: Qitu ka qenë te {bën me dorë majtas}, na i thojmë ndërtesa e Progresit, është një ndërtesë, kjo ndërtesa kur të hyn në qendër të qytetit është ndërtesa ma e naltë, përballë, përballë hotelit Theranda, e në, në bodrum të saj {lëviz dorën poshtë}. Ka pasë një hymje të hatashme si, si në Nju Jork me qenë, si në Bronx. Njëfarë gjysëm labirinti për me ardhë deri në disko. Po disko ka qenë tamam disko, disko me DJ, me kabinën për DJ, me shank, me vend për vallëzim, vend për do separeja, sende. Për Prizren, për fund të viteve të ‘70-ta ka qenë vend i hatashëm.

Aurela Kadriu: Po më intereson masi e përmendët diskon, a janë diskot si përgjigje e qasaj që ju tanë kohën ja nisët me ngu muzikën, a ju ja nisët me ngu muzikën se disko (qesh)?

Veton Nurkollari: Jo, unë kam nisë me ngu muzikë para se me shku në disko.

Aurela Kadriu: Po menoj si, si gjeneratë, po thom, çfarë lloj muzike, a ka qenë ajo, a ka kriju qajo disko kulturën apo ka ekzistuar?

Veton Nurkollari: Për Prizren besoj që po. Për shkak që ai vend ka qenë prej vendeve të rralla, mos koftë i vetmi vend ku ke mujt ti me shku me ndëgju muzikë, plus me vallzu. Nuk ka pasë vend tjetër. Në fund të viteve të '70-ta, Prizreni ka pasë dy ose tre kafiqa edhe kjo ka qenë krejt. Në qendër të qytetit në Shadërvan kanë qenë dy kafe të mëdhej, po ku ke mujt me ngu muzikë *live* {sikur i bie kitares} por me kangtare që janë do kangë për {sikur pin nga gota} kafe me rakia me thonë. I vetmi vend kështu ta qujmë, jo alternativ, po vend ku ke mujt me shku me familje e sene ka qenë terasa e hotelit Theranda ku ka pasë muzikë *live* me bende nga Prizreni.

Këto kanë qenë, tash ti nuk ke pasë ndonji zgjedhje të madhe nëse i ke pasë 15, 16, 17 vjet. Krejt ato kanë qenë sporadike, të vetmin vend ku ke dashtë me shku ka qenë disko edhe janë mundu domethanë shumë, shumë të ri cakun, qëllimin me shku në mramje ka qenë, në disko. Dy sene i kena pasë: një kinema këtu edhe një disko {tregon kahjet majtas-djathtas}. Këto kanë qenë dy sendet kryesore në këtë qytet në ato vite.

Aurela Kadriu: Kur keni nisë me shku në kinema?

Veton Nurkollari: Unë kam nisë me shku në kinema rregullisht, nuk e di kur i kam pasë ndoshta nja 15 vjet. Nashta edhe ma herët, po para asaj kam ardhë në kinema për shkak se kur kemi qenë në shkollë fillore neve na kanë pru prej shkollës në kinema. Ka ekzistuar njëfarë tradite, rregull kohë mas kohe kështu në mënyrë të organizume me ardhë me pa filma. Sidomos filma, janë quajtur atëherë filma partizanë {bën me gishta thonjëzat}. Domethanë, filma për Luftën e Dytë Botërore ndërmjet, shumicën e rasteve ndërmjet partizanëve dhe gjermanëve dhe i kemi pa shumicën e tyre në mënyrë të organizume prej shkollës.

Por, mu më ka interesu kinemaja tepër edhe kam ardhë në këtë kinema, por ka ekzistuar edhe kinemaja tjetër ku është, ku është qendra Evropa pak ma *run down* [anglisht - e vjetërsuar] kinema, pak ma kështu alternative kinema. Jo kaq e madhe, ma e vogël, por me një repertoar shumë interesant për atë kohë. Unë kam pasë shumë qejf me pa, sidomos filma *western*¹ se kanë shfaq një numër të konsiderueshëm të filmave *western* e për mu filmat *western* kanë qenë zbulim kryesor për atë kohë. Seni ma i mirë që e kom zbulu (qesh) në atë kohë kanë qenë filmat me kauboj i qujshim na.

Aurela Kadriu: A ndodh këtu njëfarë zanafille e interesit të juj për kinema në përgjithësi apo qysh nisë krejt qajo?

Veton Nurkollari: Tash në retrospektivë, unë nuk kam mendu asnjëherë atëherë që do të vjen koha që unë do të merrem me kinema në formën çfarë mirrem tash. Mu më ka interesu kinemaja *genuinely* [anglisht - sinqerisht] të them, unë shumë kam pasë qejf me pa filma. Dikur vonë kam kuptu që, masi më ka vdek baba, kam kuptu që edhe ai ka pasë njëfarë interesi në kinema. Deri në atë masë sa që kur

¹ Zhanër i filmit i cili tregon histori të vendosura kryesisht në gjysmën e fundit të shekullit të 19-të në Perëndimin e Vjetër Amerikan, shpesh duke u përqëndruar në jetën e një kauboiji apo luftimit me armë.

ka pasë edhe punëtorë në, në lokal, disa punëtorë që kanë punu, çdo të mërkurë i ka çu edhe punëtorët bashkë me, bashkë me te me shku, me shku me pa një film njëherë në javë.

Unë e kam kuptu ato vonë, asnjëherë nuk më ka ra me babën me folë për këto sendet. Por, mu çka më kujtohet si fëmijë është që shkojsha në lokal te baba me lutë, “A m’i jep dy dinarë të shkoj ta qyri një film se ka ardhë filmi i ri?” Rugës prej në shtëpi e deri në lokal ka qenë një pano e madhe {shpjegon me duar} me postera dhe orarin e filmave edhe unë shpesh u nalsha aty me pa se cili është filmi i radhës, çka ka diçka a po më intereson, a s’po më intereson? Po them shumica e filmave më interesojshin edhe shpesh kam shku.

Aurela Kadriu: A ka pasë audiencë të madhe kinemaja?

Veton Nurkollari: Po {pohon me kokë}, në krahasim me sot ose me ku ta di vitet e fundit edhe për shkak që nuk ka pasë argëtime tjera, audiencë ka pasë të hatashme. Deri në atë masë sa që nuk ka qenë e lehtë me ble biletën edhe nëse ke pasë të holla. Është dashtë ose me prit rend shumë ose, ose me ble nga stërshitësit (buzëqesh). Por, shpesh kanë qenë sallat e mbushuna përplot. Ka qenë traditë këtu, jo vetëm e të rive por edhe njerëzve ma në moshë edhe me shku me familje, me shku me pa një film edhe mas filmit me dalë, sidomos verës. Edhe plus fati i Prizrenit është që ka pasë një kinema në ambient të hapun edhe ka qenë tepër edhe për popullatën atraktive, gjatë ditëve, natëve të verës me ardhë me pa film në, në bahçe këtu {tregon me gisht majtas}. Na e qujshim bahçe kopshtin e [Kinema] Lumbardhit.

Pjesa e Dytë

Aurela Kadriu: E përmendët që keni nejt mandej shumë në lokal te baba, a keni fillu me marrë zanatin edhe ju? Qysh ka nisë, po mendoj?

Veton Nurkollari: Unë ja kam nisë jo me atë idenë që me, me marrë zanat, por me idenë m’i ndihmu për shkak që ka pasë nevoj për ndihmë. Ashtu që, dalë-ngadalë kam fillu me mësu diçka nga gjithë ai zanati për me mujt me i ndihmu. Nuk kam mbërri, ose e logjikshme ka qenë që jo menjëherë të fotografoj sepse kam qenë i vogël. Besimi me fotografu dikend nuk është bash, nuk i jipet bash lehtë. Ashtu që, kam nisë me i mësu senet tjera, me i pre fotografitë {sikur pren diçka me gërshtë}, me i klasifiku, dalë-ngadalë me nisë me mësu me i zhvillu, me i shtyp, printu, në shpi i tersha fotografitë {shpjegon me duar}. Krejt këto pjesë tjera kadal-kadale i kom mësu deri sa u mësova me fotografu edhe deri sa e mrriva njëfarë moshe edhe, edhe besimi në vetëveten që tash unë muj me dalë mbrapa atij aparatit edhe me fotografu.

Edhe veç t’ju përkujtoj aparatet e fotografimit atëherë kanë qenë sa gjysma {tregon me duar madhësinë} diçka ma e madhe se une. Une herën e parë kur kom fotografu kam hyp në karrikë se

s'kam qenë aq i gjatë sa me mujt me pa prej {me duar formon katërkëndësh}, ashtu që është dashtë me hyp në karrikë për me mujt me pa në atë {me gishta formon katërkëndësh} pasqyrën, atë dritaren se çka po fotografoj. Po mandej jom mësu kadal-kadale edhe, edhe kam ndihmu, edhe kam punu edhe masi që baba jem ka ndërpre me punu në lokal, unë kam punu deri, deri në vitin 2007 - 2008.

Aurela Kadriu: A keni bo fotografi deri 2008-tën?

Veton Nurkollari: Po (buzëqesh).

Aurela Kadriu: Çfarë kanë qenë shërbimet, interesant s'e pasna ditë që keni punu deri aq vonë (qesh)?

Veton Nurkollari: (buzëqesh) Po, kam bo çdo lloj fotografie. Po mendoj, lokali ka qenë klasik lokal fotografik, ku kemi fotografu për nevoja çfarëdo qofshin. Fotografi dokumentash {numëron në gishta}, kemi zhvillu fotografitë, njëherë një kohë të gjatë fotografi bardh e zi. Mas një kohe edhe fotografitë me ngjyra, kemi bo shërbime edhe për ahengje familjare, dasma, bile-bile edhe, edhe varrime shumë pak, po edhe ato kemi fotografu (buzëqesh). Shumicën e asaj çka bën një fotograf kemi bo.

Aurela Kadriu: Para se me, para, para kësaj kohës moderne, qatëherë kur keni qenë i vogël që keni fotografu me babën kush u fotografojke për çka ishin qëllimet që dojshin njerëzit m'u fotografu?

Veton Nurkollari: Kryesisht kanë ardhë për nevojat që kanë të bëjnë me dokumente. Domethanë, për secilin dokument të asaj kohe e që dallon prej sot është dashtë me pasë një fotografi edhe për letërnjoftim, edhe për pasaportë, edhe për leje të vozitjes edhe për librezë të ndryshme. Autoritetet e atëhershme kanë kërkuar fotografi edhe fotografitë të vetmit që kanë mujt me bo kanë qenë fotografët. Për atë pjesë të them kështu, kryesore e punës të një fotografi të asaj kohe kanë qenë fotografitë e, e dokumenteve një, edhe fotografitë për kujtesë. E tash kujtimi ka mujt me qenë fotografi familjare, fotografi të themi për dy, për një çift, për martesë, para martesës, {numëron në gishta} mas martesës, fotografi gjatë martesës, fotografi me, me rroba të martesës ta qujmë, kesi lloj fotografi. Shumicën e rasteve fotografi për memorje, për kujtim, për për ta imortalizu ta quaj momentin.

Domethanë, njerëzit kanë pasë qef edhe dëshirë me u fotografu për, për me majtë në kujtesë një moment edhe shumë pak kanë ekzistuar, gati kanë qenë inekzistente video-kamerat, edhe i vetmi mjet për me majtë në mend, me bo kujtesë kanë qenë fotografitë. Ashtu që, nevoja për me bo fotografi ka qenë mjaft ma e madhe se sot edhe unë them momentin që është paraqit një ekran në të cilin njeriu mundet me pa fotografinë është momenti kur ka vdek fotografia analoge. Ose është, nuk ka vdek po, po ka qenë një moment tepër i randësishëm për mënyrën se si perceptohet fotografia edhe nevoja e fotografisë. Ne sot fotografojmë me telefona dhe nevojën për me pa e, e kemi në moment, në momentin edhe me paraqitjen e fotografisë digjitale edhe në momentin që ti menjëherë mas fotografimit e ke fotografinë, mundësinë për me e pa fotografinë është momenti, për mendimin tim krucial kur nevoja për... ose, ose fotografia analoge ka nisë, mund ta them kështu lirisht m'u zhdruk.

Ndryshe ka qenë edhe nëse vet ke fotografu, edhe nëse ke shku te fotografi prej momentin kur je fotografu edhe deri te momenti kur e ke pa fotografinë, ka qenë një, një periudhë që ka mujt me qenë një ditë, dy ditë, tre ditë, pesë ditë, po, me ditë. Edhe ka qenë... është një moment për secilin, i pritjes se çka do të shihet edhe si do ta shihet. Unë nga ajo ana tjetër, unë kam pa myshteri çdo ditë me, me, s'po di qysh me qujt atë, me mënyra të ndryshme të reagimit në momentin kur i marrin fotografitë edhe i shohin {shikon duart}, "Aaa {onomatope} kështu e ashtu e..." Ose momentin e dëshprimit që dikujt nuk i ka dalë asgjë. Se te na shpesh i kanë sjellë filmat që nuk kanë ditë me i vendos si duhet në aparat, kur kanë sjellë s'ka kurgjo. Është moment, janë momente të jashtëzakonshme dëshprimit të njerëzve me pa që kurgjo prej atyre momenteve që ata kanë mendu {sikur shkrep fotografi} që i kanë fotografu nuk janë.

Aurela Kadriu: Në të kalumen a ka qenë, a ka qenë ky shërbim i shtrenjtë, po më intereson a ka qenë najfarë privilegji i të pasunve për me bo fotografi familjare, me bo fotografi për qejf?

Veton Nurkollari: Po, deri diku po. Jo edhe në atë, në atë aspektin që vetëm të pasurit kanë mujt me bo, për shkak që divizioni ndërmjet të pasurit dhe të varfërit ka qenë ma pak i theksuar se sot. Sot kemi shumë ma shumë shtresa të varfuna, që janë me të vërtetë të varfuna, edhe shtresa {ngrit dorën lartë} ose një shtresë e vogël e atyre që janë tepër të pasun. Në atë kohë ka pasë shumë ma shumë njerëz që kanë pasë, po nuk ka pasë njerëz që kanë qenë tepër të pasun. Bile-bile edhe ai që ka qenë i varfun ka mujt vetes me ja mundësu së paku ndonjë lloj të fotografisë.

Po s'po di qysh me, qysh me e, qysh me u shpreh ma mirë me thonë që në esencë atëherë fotografia ka qenë shumë ma e qasshme për një, për një shtresë shumë ma të gjonë. Tash s'po di fotografinë me çka me e krahasu, nëse e krahasojmë me, me, me për shembull me telefon edhe ajo nuk është naj krahasim i madh për shkak që edhe telefona ka çdokush, po s'po di qysh me krahasu. Ka qenë, ka qenë qasshëm për, për, për shumë, një pjesë të mirë. Edhe pse jo çdokush ka mujt me, me, me pasë për shkak që nëse ke dashtë vet me bo, ti është dashtë me pasë një aparat i cili ka qenë njëfarë investimi. Mandej është dashtë me pasë, sado pak me ble një film me zhvillu, ato e me pagu, por nuk ka qenë ndonji kosto e madhe.

Aurela Kadriu: Ku e keni pasur lokalin?

Veton Nurkollari: Lokalin e kena pasë jo larg prej këtu, në prej sheshit Shadërvan {tregon me dorë} e rruga që të çon për, për, për kishën. Ndërmjet kishës katolike dhe kishës ortodokse nëse e din ku është "Kinezi", menjëherë përfundi "Kinezit".

Aurela Kadriu: Po, po. Po më intereson fotografia me ngjyra kur ka ardhë ju me siguri e mbani në mend kur ka ardhë në Prizren, çfarë momenti ka qenë kështu për juve?

Veton Nurkollari: Po a din si duhet me dallu kur ka ardhë fotografia... disa fotografi me ngjyra kanë ardhë shumë ma herët sesa që fizikisht ka ardhë mundësia me pasë fotografinë me ngjyra për shkak njerëzve që kanë qenë nëpër vendet, vendet tjera. Unë mbaj në mend që disa prej fotografive të para me ngjyra i kam pa nga një kushëri i yni që jetonte në, në Kanada e na i dërgonte disa {me gishta formon katërkëndësh}, disa fotografi polaroida² me ngjyra, për mu kanë qenë fotografitë e para që i kam pa edhe pse kam qenë fëmijë.

Fotografitë e para që kanë bo njerëzit, domethanë banorët e Prizrenit edhe janë shtyp, janë bo në fakt në Prishtinë. Për shkak që makinën e parë për shtypje të fotografive me ngjyra i ka sjell babai im, tash provoj me kujtu vitin... po para asaj fotografitë me ngjyra na i kemi përpunu te Foto Nesha, për një kohë të gjatë, ka qenë njëfarë sistemi si me i dërgu filmat e ku zhvillohen e të nesërmen apo mas dy dite me i marrë. Kështu e kemi pasë njëfarë cikli dy herë në javë me shku deri në Prishtinë me i përpunu me i marrë për një, për një periudhë, me siguri disa vjet ka qenë ky sistem deri sa unë e binda disi babën që është koha me investu në një, në një makineri edhe mandej shkova në Vjenë edhe në Zagreb, edhe në Vjenë. Pastaj e organizum e sjellëm edhe e montum makinën e parë mrenda në lokal ka qenë.

Aurela Kadriu: Keni shku ju vet në Vjenë, keni udhëtu?

Veton Nurkollari: Po.

Aurela Kadriu: A na tregon qysh ka qenë, po mendoj kam shumë qef me ditë kur ju keni udhëtu me qesi misione se s'ka ndodh shumë në atë kohë. Qysh ka qenë Vjena?

Veton Nurkollari: Nuk kam pa atëherë shumë prej Vjenës me të kallxu drejtë, për shkak që unë shkova në Vjenë, në selinë e, e, e Kodak³ për trajnim. Makinën e patëm ble edhe aranzhu nëpërmjet një ndërmjetsuesi, njëfarë firme nga Kroacia, por me seli në Austri. Na e aranzhum krejt ato po ishte koha kur po vjen një makinë të cilën askush në Kosovë, asnjëherë nuk e ka pa, përfshi edhe mu e unë duhet tash të punoj me atë makinë. S'kom ditë, idenë... s'kom ditë çka bon, qysh bohet. Kam pasë shku disa herë te, te Nesha, mirëpo ajo aq e komplikume si, si një laborator me shumë sene. Kur, kur e patëm nënshkru atë kontratë edhe e bonëm një pjesë të pagesës u morëm vesh që kjo firma ndërmjetësuese të na siguroj një, një trajnim disa ditor në qendrën e Kodakut në Vjenë. Ashtu që, une shkova në Vjenë, shkova në Zagreb në fakt edhe prej Zagrebit shkova në, me tren në, në Vjenë. Edhe ndodhën aty disa

²Lloj i kamerës që përdor filmin vetë-zhvillues për të krijuar një printim të zhvilluar kimikisht menjëherë pas fotografimit.

³ Kompani e teknologjisë amerikane që prodhon produkte të lidhura me kamerën me bazën e saj historike në fotografi.

momente interesante natyrisht pa, që nuk i shkojnë ndërmend njeriut që mundet me ndodh. Unë mrriva në Zagreb dhe në Zagreb ishte një, një, një turmë e jashtëzakonshme e njerëzve.

[Këtu ndërprehet intervista]

Këtu hypa në tren edhe shkova në, në Vjenë edhe në Vjenë isha në Kodak për disa ditë, tanë ditën njëfarë trajnimi për atë punë. Kur mora m'u kthy, shkova në, me hyp në tren prapë për m'u kthy në Zagreb se pata edhe një biletë aeroplani në Zagreb me ardh deri në Shkup edhe para asaj me i kry do, do punë të shpëdicionit me pagu diçka edhe makinën me e fut në kamion me e sjell në, në Prizren. Kur mora me hyp në tren nuk ma dhanë biletën thanë, "Jo, nuk ka tren, nuk asi... është luftë". (qesh) Atëherë kuptova që ka nis lufta në Slloveni (qesh). Ide s'kam pasë se çka po ndodh, kanë qenë trazirat sene, mirëpo nuk ma murr menja ose qysh senet mujn me shpejtu sa që ushtria jugosllave ka hi në Slloveni edhe e kanë mbyllë gjithë kufinin.

Treni prej Vjenës për në Zagreb kalon nëpërmjet Sllovenisë, ashtu që s'ka pasë as tren {përplas duart}. Kështu e gjeta disi, e gjeta njëfarë aeroplani erdha me aeroplan prej Vjenës. Për Zagreb disi shpejtë e shpejtë e futëm disi atë makinën me një kamion me targa të Ohrit diçka më kujtohet edhe une prapë me një qyk të zorrit gjeta një aeroplan tjetër për me shku deri në Shkup. Kanë qenë disa momente kështu interesante, por rastësi jo që...

E Vjena, atë herën e parë nuk kam pa, nuk kam pa shumë po mandej unë kam udhëtu mjaft edhe si i ri kam udhëtu edhe nëpër Evropë edhe bashkë me disa shokë këtu, kemi qenë kogja kështu të primë me eksploru edhe mundësitë edhe... Dikush na pat tregu që ekziston mundësia me udhëtu me *interrail*⁴ bileta, ashtu që njëherë e zbulum *interrail*-in pastaj na u bë Evropa afër kështu. Unë e kam shfrytëzu disa herë, kam shku gati krejt Evropën me, kështu me tren e... për shumë pak pare.

Aurela Kadriu: A ka qenë e lehtë me udhëtu në atë kohë? A na tregon kah keni udhëtu, në cilat vite dhe është shumë e randësishme se sot ka diskutime për neve për shembull, për gjeneratën teme Evropa është larg, shumë larg. E për gjeneratën e juaj ka ekzistuar njëfarë kohe që ka qenë tepër afër edhe për babën tem për shembull. Shumë vende të Evropës që për mu janë sfidë me mbërri, baba jem ka shku veç për një vikend, ka pasë qef me shku edhe ka shku.

Veton Nurkollari: Po, njëherë duhet me kuptu që në ato vite udhëtimi për Evropë ka qenë sikur me shku kudo, ashtu që nuk ka pasë viza. I vetmi, dy shtetet e vetme sa e maj në mend une që është dashtë me pasë vizë, po edhe ato vizat ti i merrshe në kufi, ka qenë Greqia edhe Anglia. Edhe për të dy shtetet vizën e merrshe në kufi, prej shteteve tjera nuk ka pasë kurrfarë pengese. Që ke mujt ti a hyp në kerr, a hyp në autobus, a hyp në tren, a hyp në aeroplan nëse ki mundësi ke mujt me udhëtu lirë. Edhe na e kena shfrytëzu shumë mirë këtë mundësi.

⁴ Biletë që paguhet me çmim të caktuar dhe shfrytëzohet për t'i vizituar disa shtete të ndryshme.

Unë kam udhëtu, i kam pas 22 vjet, 1984-tën e kam bo *interrail*-in e parë edhe kam udhëtu tash të kallxoj nëpër Evropën Perëndimore, në Austri, e Gjermani, e Holandë, e Angli, mandej deri në Spanjë, e Francë, e Itali, e Greqi, e mbrapa në Kosovë edhe vitin tjetër edhe një herë po bashkë me Skandinavi, komplet Skandinavinë e dej në Spanjë e prej Spanjës prapë në Skandinavi, qishte na u dokke Evropa shumë afër se hyshe në tren shkojshe. Treni të çojke, një herë {ngrit gishtin tregues} e blejshe biletën e cila tëherë ka kushtu, nëse e kthej atë në, në euro tash, diçka nën 200 euro. Domethënë diçka 300 e diçka, në 400 marka. Biletë një mujore për tren kud në Evropë. Edhe natyrisht (qesh) ka qenë një send që menxi kena prit me shfrytëzu, me pa. Udhëtojsim me shumë pak pare, shumicën e rasteve nuk pagujshim asnjë fjetje për shkak që flejsim në tren. Udhëtojsim natën e shihshim qytetin ditën, ushqeheshim çka, çka osht' ma e lirë.

Aurela Kadriu: Ma e lira.

Veton Nurkollari: Natën prapë në tren deri në qytet tjetër, gjumë në tren {përplas duart} super.

Aurela Kadriu: Çfarë shoqërie ka qenë kjo e juja, çfarë grupi shoqëror keni qenë, kështu i afërt?

Veton Nurkollari: Po kemi qenë disa shokë edhe disa shoqe, po në përgjithësi shokët. Po prej atyre shokëve disa kanë qenë kështu të ngjashëm sikur une, nifare avanturista për me shku. Kështu që, na kursejsim tanë vitin, secili prej neve punojke diçka, për shembull njoni prej atyre shokëve ka pasë një shitore të vogël shitke akullore {sikur mban akullore në duar}. Ai tjetri shitke e ka pasë njëfarë shitore të suvenirave. Një tjetër punojke me babën e vet, ka pasë pastrim kimik (buzëqesh). Po secili prej neve punojke diçka, secili prej neve ka pasë mundësi kapak me, me fitu diçka edhe me kursy. Deri sa na ra ndërmend me kriju bankën tonë, njonit prej neve se jo mu, po, u kujtu tha, “Na a s’bon” tha “na masi po takohem çdo ditë” tha “secili prej neve me i qitë do pare”. Edhe e bonëm një bankë çdo ditë i jepshim atij ka pesë dinarë, a pesë marka qishte, pak pare diçka, po ato pak pare brenda vitit u bojshin tamam pare për, për me udhëtu ni vjet, për ni muj (buzëqesh).

Aurela Kadriu: (qesh) Shumë interesant me i mbledh pare, bash, bash ide e mirë. A ka qenë Prizreni najfarë destinacioni turistik në atë kohë, a vrejshit najfarë se më ra ndër mend që thatë ka pas njëfarë dyqani të suvenirave?

Veton Nurkollari: Suvenira kur thash ma shumë kanë qenë prej drurit {përshkruan objektin me duar} diçka, po jo numër turistave çfarë ka tash. Qaq pak ka pasë turista, sa që u dike menjëherë nëse ka ardhë naj turist. Edhe nëse ka ardhë naj turist secili prej neve e kuptojke, “A paskan ardhë do gjermanë” ku ta di une, “Tre gjermanë, e një, dy gjermanka paskan ardhë”. E mule me pa ku janë ata, kush janë ata (qesh). Kështu njëfarë atmosfere ka qenë. Përveç hotelit Theranda ka qenë edhe një hotel i vogël, ma shumë si njëfarë motel është qujt. Nuk ekziston mo, po ka qenë njëfarë ambienti interesant me, me disa kamp shtëpiza {shpjegon me duar} buzë lumit edhe turistat nëse vijshin, vijshin atje edhe na shkojsim me pa kush janë ata turista, kush ka ardhë në Prizren (qesh). Ka qenë njëfarë

fascinimi i çuditshëm me njerëz të huj që vinin në këtë qytet, me i pa, me i taku, me folë. Mendoj ka kalu ajo, por në atë kohë ka qenë interesant që u nike shpejtë nëse kanë ardhë në qytet turista.

Aurela Kadriu: Ku e keni kry shërbimin ushtarak që e përmendët më herët?

Veton Nurkollari: Shërbimin ushtarak e kam kry në Manastir edhe Ohër. Pak a shumë në periudhë të njëjtë, gjysmën e parë në Manastir, Bitolla u qujke atëherë edhe gjysmën e dytë në Ohër.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë?

Veton Nurkollari: Po në kohën shumë të papërshtatshme (qesh). Kur kam shku ushtar i kam pas 19 vjet, menjëherë mas shkollës së mesme. Kurgjo as s'kam ditë, as s'kam qenë i përgaditur si shumica e gjeneratës time. Po neve na zuni njëfarë ndërrimi i ligjit atëherë edhe u bo sa e di une gjenerata e parë që shkoj në ushtri menjëherë mas shkollës së mesme, me njëfarë kushti që me qenë një vjet ushtar edhe m'u kthy në fakultet edhe mas përfundimit të fakultetit me shku edhe me kry edhe ato tre muj tjera obligative për shkak që 15 muj ka qenë, ka qenë shërbimi ushtarak. E m'u ka dok tepër i ri me shku atëherë, as 19 vjet prej një ta quaj kështu lirie e kena pasë edhe në familje, edhe në shoqni, edhe krejt, në një, në një sistem rigoroz (qesh), ku... po ajo ka qenë një send. Sendi tjetër ka qenë, sendi i papërshtatshëm në fakt që neve na zuni, me qenë në shërbim ushtarak në vitin 1981, kur ndodhën demonstratat e para në Kosovë edhe kur ndërroi kështu rrënjësisht njëfarë perceptimi ndaj shqiptarëve në ushtri.

[Këtu ndërprehet intervista]

Aurela Kadriu: Flisni për shërbimin ushtarak edhe pak.

Veton Nurkollari: Okej.

Aurela Kadriu: Keni nejt një vit edhe qysh ka qenë me dalë prej shkollës mesme në shërbim ushtarak?

Veton Nurkollari: Po s'ka qenë lehtë, a din qysh, je mësu nifare rehatie, një të them kështu 18 vjeçarit, mos me shumë sene, me shku në shkollë, e une punojsha pak në lokal me babën. Po kam pasë mjaft liri, me bo çkado, me dalë edhe me një moment menjëherë na u cungu krejt ajo edhe u gjeta në një vend, hapësinë, sistem komplet tjetër pak i papërgaditur po mas një kohe, qysh me thonë, u adaptova. Po them edhe një herë problem ka qenë pjesa e dytë e, e ushtrisë kur ndodhën demonstratat e para të vitit '81 në Kosovë e neve na zuni ajo në ushtri. Edhe nuk ishte një ndjenjë e mirë, duhet kështu të pranoj, me qenë shqiptar në një ambient i cili gati menjëherë u, u, u bo si i armiqësor.

Na, na shihshin si fajtorë edhe pse s'kena bo kurgjo (qesh) po vetëm duke qenë shqiptar në atë kohë të bojke njëfarë fajtori edhe me të thon të drejtën menxi e kam prit me kry atë, atë shërbim ushtarak

edhe me u kthy mandej shpejt u adaptova këtu mas, mas shërbimit ushtarak. Po në anën tjetër komplet ai viti për shkak që ka qenë krejt ndryshe, kështu në retrospektivë ka qenë edhe i dobishëm. Për m'u, për m'u adaptu apo klimatizu me një sistem rigoroz, rigjid të disiplinës dhe krejt seneve tjera që nuk i kena pasë këtu e që nuk më pëlqejke atëherë, por që mendoj që ma vonë nashta më ka ndimur për, për disa sende m'i kuptu, se në jetë (buzëqesh) të nevojiten edhe pak, disciplina pak, me i përfitu disa aftësi që me siguri nuk kisha mujt m'i, m'i marrë nëse s'kisha shku.

Aurela Kadriu: A keni pasë shqiptarë tjerë?

Veton Nurkollari: Po ka pasë mjaft, po. Ka pasë mjaft shqiptarë. Bile-bile kam pasë edhe disa shokë prej shkollës që qashtu na ka ra fati me qenë. E që ka qenë mjaft mirë se ke mujt me kalu pak kohën e lirë me njerëz që i njeh, sidomos në fillim. Se mandej ti po adaptohesh, po fillimi, disa javë të para m'u duke shumë çuditshëm aty, s'i njihsje njerëzit e menxi pritshe me ardhë koha, kur ki pak kohë të lirë ose kur pret rend për ushqim m'u shoqnu edhe me folë pak gjuhën tonde e qesi sene. Për me qenë me njerëz që i njeh se përndryshe shumë njerëz të panjoftun, shumë njerëz të krejt anëve të Jugosllavisë. E u dashtë me qenë i veshun i mathun e me i respektu do, do rregulla, do sene. Po ka pasë, ka pasë edhe mendoj që ka qenë bash, bash mirë që së paku qato javët e para ke mujt me kalu pak kohë me njerëz që i njeh.

Aurela Kadriu: Çka bojshit në kohë të lirë në ushtri? A keni mujt pak a shumë me pasë njëfarë shije të asaj jetës me ngu muzikë ose me...

Veton Nurkollari: S'na lojshin me ngu muzikë, une e kom pasë njëfarë tranzistori ka qenë i vetmi burim i, i (qesh), i informatave edhe pak i muzikës. Njëfarë tranzistori i vogël me bateri. Përndryshe, nuk na lejshin me ngu muzikë, çfarë! Kurgjo hiç! Sport me dalë me luft diçka, najfarë futbollit edhe me vrapu pak e m'u enë pak mrena kazermës po, po edhe aty ka pasë kufizime edhe cungim. Ti ki mujt me kalu kohën e lirë, ka ekzistuar njëfarë kantine u qujke, diku ku ke mujt me ble ndonji pije, sene, qajo. Nuk ka pasë shumë mundësi. Unë jam inkoadru me njëfarë grupi artistik e kena provu pak me bo, domethanë me inicu një shfaqje teatrale kemi inicu e qesi do sene të vogla sa me mujt me, mos me nejt se m'vike palidhje me nejt aty, kur s'ki kurgjo çka bon ose në shtrat, palidhje u doke.

Aurela Kadriu: Çfare ka qenë shfaqja, a na tregon?

Veton Nurkollari: Njëfarë {shikon përreth} s'di, s'po më kujtohet bash çfare ka qenë shfaqja po e di që e kena bo ni shfaqje për, për, për një ditë, për një ditë socializmit diçka po s'po më kujtohet çka. E di që i kena pre do germa, {sikur pren diçka me gërshtë} e me stiropor e... njëfarë shfaqje. Kurgjo gjysë banale diçka (qesh), mos të thom revolucionare po në atë frymë diçka.

Aurela Kadriu: Kur u kthyt prej ushtrisë mandej, kallxut ma herët që keni dashtë, keni nisë me studiu diçka e çka keni studiu?

Veton Nurkollari: (qesh) Po kur u ktheva prej ushtrisë shkova në studime menjëherë, po studiova për një vjet ekonominë edhe m'u duk shumë, shumë jo interesant për mu edhe e lash edhe menjëherë e regjistrova Gjuhën edhe Letërsinë Angleze edhe atë e studiova e kryva vitin e parë edhe qaq.

Aurela Kadriu: E pse i patët zgjedh qeto dy degë, ekonominë ma s'pari, pse?

Veton Nurkollari: Ekonominë e zgjedha prej zorit, jo prej qefit. M'u dasht me regjistru diçka për me mujt me, me kry ushtrinë tre muj ma herët.

Aurela Kadriu: Aha.

Veton Nurkollari: Unë idealisht dojsha me studiu turizmin, po dy fakultetet e vetme në ish-Jugosllavi atëherë ka qenë njena në Ohër, njena në Rijekë edhe e huqa...

Aurela Kadriu: Afatin.

Veton Nurkollari: Afatin për provim pranus për shkak të një budallakie të vogël gjatë, gjatë gjimnazit se m'u dasht me... s'mujta me diplomu menjëherë, po diplomova në afat të dytë edhe ai diplomimi i vonshëm pamundësoi me regjistru, me apliku në fakt për m'u regjistru. Ashtu që, u dasht me regjistru diçka për mos me, mos me bo ushtrim 15 muj po 12 muj ashtu që veç e regjistrova ekonominë sa me pasë diçka të regjistrume edhe me pasë vërtetimin {sikur shkruan diçka në dorë} që me m'lëshu tre muj ma herët prej ushtrisë. Qashtu ka qenë atëherë dymdhetë plus tre e qujshin, me një vërtetim që je i regjistrum në, në, në fakultet e kryjshe ushtrinë tre muj ma herët, me kusht që mandej kur ta kryen fakultetin me shku me i bo edhe ato tre muj të tjera, të cilat asnjëherë nuk i bona une (qesh).

Aurela Kadriu: A jetuat në Prishtinë qato dy vjet?

Veton Nurkollari: Jo, kam studiu atëherë u qujke me korespondencë, asnjëherë s'kam... veç shkojsha disa ligjerata edhe në provime, po asnjëherë nuk e kam jetu jetën studentore kështu.

Aurela Kadriu: Çfare ka qenë po menoj për juve qekjo jeta, minimalisht studentore, udhëtojsh për Prishtinë?

Veton Nurkollari: (qesh) Udhëtojsha po, udhëtojsha...

Aurela Kadriu: A ka pasë atëhere linja të rregullta të udhëtimit?

Veton Nurkollari: Po. Po, po ka pasë linja, po.

Pjesa e Tretë

Aurela Kadriu: Para se me dalë te të '90-tat si një periudhë e gjanë, po kom qef me fol pak, po më intereson a keni pasë gramofon në shtëpi, edhe a e keni pasë... ?

Veton Nurkollari: (buzëqesh) Po, kam edhe storjen e gramafonit, tash i kam edhe nja tre gramofona. Po e kam pasë një gramofon, në fakt shumë sene lidhen me qat' gramofon edhe me qat' storjen e gramafonit. Gramafonin e parë e kam pasë shumë moti, kur në esencë baba im pat kalu prej një lokalit në lokalin tjetër edhe ai lokali në të cilin baba ka nisë me punu, para asaj ka qenë një servis për televizora, radio, tv servisa janë qujt atëherë. Edhe kur kemi hi në lokal, kur ka hi baba ka pasë plot do televizora të vjetër të prisht, radio edhe një gramofon {ngrit gishtin tregues} (buzëqesh). Ama gramafoni super edhe t'u punu edhe natyrisht une si i ri, pak i dhonën për muzikë une e konfiskova atë gramafonin menjherë edhe e solla në shpi. Mirëpo, s'kam pasë pllaka.

E për fat në Prizren në atë kohë ka ekzistuar një, një shitore e pllakave. Ku ke mujt me ble pllaka, qofshin pllaka të muzikës popullore, qofshin muzikës të Jugosllavisë, po ka pasë edhe pllaka të muzikës që më interesojke mu. Ashtu që, une ja nisa me ble pllaka edhe këto janë fillet e interesimit tim për muzikë. Mas një kohe natyrisht kam nisë me ble pllaka serioze kështu ta quj, pllakat që më kanë interesu edhe prej udhëtimeve ndërkohë e kam ble edhe një gramofon, mas një kohe të gjatë i kam ble edhe nja dy gramofona tjerë. Ashtu që e kam njëfarë koleksioni të gramafonave ende në shtëpi edhe një koleksion të madh të pllakave. Po për fat të mirë apo për fat s'po di qysh me qujt ato, një pjesë e mirë e atij koleksionit tim kanë udhëtuar bashkë me vajzën time në Gjermani, e cila disi e ka trashëgu njëfarë dashnie për muzikë edhe njëfarë shije për muzikën të cilën unë e kam nga. Kështu që, një pjesë të mirë të koleksionit tash janë në Minhen dikun te Aneta (buzëqesh).

Aurela Kadriu: A e dishit randësinë e gramafonit, po më intereson çka edhe sot në retrospektivë, po kom qef me juve me diskutu pak edhe në rrafsh të vlerave, çka ka qenë për juve gramafoni atëherë, çka janë sot pllakat për juve pse jeni ende fanatik i pllakave?

Veton Nurkollari: Po, në gramafon ka qenë krejt (buzëqesh). Unë në shkollën e mesme kam nga muzikë nëpërmjet një tranzistorit edhe gramafon. Po natën me kuptu se çka është muzika mirë edhe, edhe në trend edhe interesante u dasht me nga radio sepse nuk ka pas këtu me ble qaq shumë muzikë apo asi lloj muzike që më ka interesu mu, thjesht nuk ka pas. Diçka shumë pak ka pas nëse dikush ka udhëtuar jashtë, ka mujt me pru diçka nëse vet kom udhëtuar. Po në shkollën e mesme ende nuk kam udhëtuar, kështu që ndëgjojsha Radio Luksemburg si shumica e, e, e njerëzve të gjeneratës time. Në ora dymdhetë ka qenë njëfarë top liste me kuptu se cilat janë kangët, cilat janë hite në atë kohë në botë.

Kështu që prej asaj kemi mujt me ditë pak a shumë se çka janë hitet edhe bile-bile kena tentu edhe me inçizu kapak nëpër do kaseta edhe pse normal inçizimi nuk ka qenë ku me ditë çka, herë u nijke mirë,

herë su nijke mirë ajo u inçizojke qashtu keq. Po sa me pasë njëfarë informate, na ka majt qajo njëfarë radio stacion atëherë i famshëm, unë nuk e di tash a ekziston, mirëpo atëherë u qujt Radio Luksemburg edhe pse është emitu prej Londrës edhe ka, ka emitu top listën e kangëve cilat janë ma të votume, ma të popullarizume, kangë që janë në top listë. Ashtu që, pak a shumë kemi ditë se çka është në trend. Po pllakat mas një kohe kam nisë m'i ble. Prej udhëtimeve kam nisë me kursy pak pare edhe me i ble edhe kam mbërri kadal-kadale me kriju njëfarë, njëfarë koleksioni timin.

Aurela Kadriu: A munesh me bo najsën me to tash apo i mbani vetëm për, për qef?

Veton Nurkollari: Jo i mbaj. Para disa ditëve më erdh një dërgesë, një letër që është njëfarë dërgese në postë edhe shkova në post edhe e pash një, një paket të vogël edhe mrena në paket dy albume të Radiohead të cilat mi ka dërgu një shok nga Nju Jorku, sepse u takum diku edhe unë e pash një album të Radiohead, po s'ke puna me ble se nuk ishte shitore po ishte një si, si diçka e ngjashme si Dit'⁵ e nat⁵ e në koleksion unë e pash po atij i ka ra ndërmend edhe tash ma kish dërgu, jo ato po edhe një tjetër. Është koleksion nuk e di, për mu ka vlerë jo vetëm si diçka prej ku ngon muzikë, po jom disi sentimentalisht i lidhun me shumë pllaka, kam disa pllaka që janë mendoj, me siguri kanë edhe ndonjë vlerë po për mu kanë shumë vlerë. Kam *single*-in e parë London Calling, për shembull Clash, kam disa albume që janë të rralla, në një kohë pata gjet mundësinë si me porosit prej Amerikës në kohën e Jugosllavisë me postë me pagu edhe me ardh. Si njëfarë mundësie që unë e zbulova disi edhe rregullisht porositsha pllaka, dikun të '90-tave. E kam albumin e parë të Nirvana për shembull, me do gabime drejtshkrimore që tash po flitet që janë me vlerë për shkak që shtypi i dytë kanë pa gabimet e kanë shtyp si duhet, po une e kom me ato gabime.

Aurela Kadriu: Aha, okej. Po du me dalë te koncertet, Aneta edhe Andrra më kanë tregu që keni qenë nëpër shumë koncerte dhe dje folëm pak, kur ja keni fillu me shku nëpër koncerte edhe pse ka qenë qaq e randësishme për juve me ngu muzikën *live* teksa keni pasë pllaka?

Veton Nurkollari: Nuk e di saktë kur, pse, po mjaft herët kam, kam zbulu që koncertet janë diçka tjetër. Ashtu që, pas të parit, dytit, tretit veç m'u ka rritë qysh me thanë disi dashnia për me shku me pa bendet të cilat i kam pasë qejf *live* edhe kam mbërri me pa goxha do bende, jo ku me dit sa shumë po s'kom pritu, kom shku, kam udhëtu enkas edhe për koncerte herë vet, herë me dikond. Vëllau ka jetu në Gjermani, ashtu që kam pasë njëfarë lidhje edhe një lehtësi, edhe një mundësi e udhëtimit deri në Gjermani shpesh ose me autobus ose me dikend, nuk kam pas ndonji harxhim të madh për me nejt atje se kam pasë vend. Ai është njëjtë i pasionum sikur unë për koncerte, kështu që e kena shfrytëzu rastin shpesh kur kam qenë në Mynhen kemi shku kena pa diçka. Po kam shku edhe enkas. Një herë kam udhëtu deri në Irlandë me pa U2, shumë moti. Njëherë me një shok kemi udhëtu me pa David Bowie edhe Pixies, pa ndonjë obligim tjetër, kemi hyp në tren këtu, kemi marrë vëllaun kemi shku deri afër Shtutgardit diku. Nganjëherë me ka ra rastësisht, Radiohead e kam pa gjysë rastësisht, se jom

⁵ Kafe dhe librari në Prishtinë e themeluar në vitin 2009, dhe platformë kulturore për muzikë, letërsi dhe film.

zatet me një qytet e ata kanë qenë aty, e gjeta një biletë. Tash së fundi shkova me familjen me pa Nick Cave.

Aurela Kadriu: Nick Cave.

Veton Nurkollari: Kështu kam, ende sot e kësaj dite kam njëfarë dashni të madhe me shku me pa koncerte. Me Andrrën isha me pa Kraftwerk për të dytën herë. Nick Cave e pash për të tretën herë, ashtu që po moti kam pasë... Si mjaft i ri në fakt, edhe ndoshta koncerti i parë i madh ka qenë Eric Clapton në Beograd, ku gati askush s'ka shku, po mendoj nuk ka ardhë kërkush ma i njoftun në atë kohë '83 më duket, diku në fillim, janar '83-tës qitu dikun, qato vitet. Veç hypa në autobus në pikë të dimrit shkova (qesh), shkova me pa Eric Clapton. Diçka e jashtëzakonshme m'u ka dok, unë i ri e gjithë ai Eric Clapton aty s'mujsha as me besu që është Eric Clapton, t'u thon, "Jo, është e pamundur diçka". Po veç ma ka shtu mandej ashtu që s'kam pritu, as tash nuk pritoj nëse është diçka interesant edhe kam mundësi të shkoj. Tash jam t'u përgaditë me shku me pa Peter Murphey në Beograd, në nëntor, qashtu.

Aurela Kadriu: A keni naj kujtim, specifike diçka që kishit pasë qef me na tregu prej koncerteve?

Veton Nurkollari: Kom plot, plot kujtime nuk e di çka kishte me qenë ma interesant për këtë bisedë. Kam kujtesë për Radiohead për shkak që as se kam prit edhe veç isha në Paris edhe e pash pllakatat që mas dy-tre dite diku është koncerti, unë isha në Francë edhe shkova u mundova me gjet një biletë po ishin shit biletat edhe ashtu që tentova qat' ditë kur është koncerti shkova pak ma herët edhe mora një copë letër një karton qishtu {bën sikur shkruan} e pyta dikend aty thash, "Qysh shkruhet 'Po kërkoj biletë' në frangjisht?" (qesh) edhe e shkruajta aty 'Le cherche bileta' (qesh) qishtu diçka edhe e majsha qishtu {sikur mban me dy duar një letër} deri sa m'u afru dikush, "A mister, mister..." [anglisht - zotëri] diçka, 100 euro, 80 euro edhe e bleva biletën. E bleva po kesh gjys i bindun se më ka mashtru nuk kesh i sigurt edhe pse m'u dukë shumë origjinal bileta deri sa hina mrena. Kur hina mrena njëfarë gëzimi, kështu.

Njejtë kam shku me pa U2 pa biletë, pa kurgjo hiç, prej këtu deri në Irlandë veç vet. I bona nja tri ditë rrugë me trena, me anije, me një vend që {ngrit dy duart} kurrë në jetë as s'kam pasë dëgju që ekziston qyteti me atë emër. E gjeta qytetin me një hartë kështu {sikur shfleton libër} me një atllasi, se s'ka pasë as google as internet as kurgjo hiç, as... veç u nisa qashtu e ka plot. Njiherë s'na lanë me i shti aparatat mrena për David Bowie, ajo më dhimet shumë, na e kthyn prej derës. U dashtë mandej me shku me gjetë {sikur fut çelësin} një *locker* [anglisht - dollap] e me shti aparatet e qishtu.

Aurela Kadriu: Po më intereson nëse vazhdoni me i ndjekë koncertet...

Veton Nurkollari: I pitë kam qenë dërrasë për Sonic Youth, ajo më kujtohet (qesh)

Aurela Kadriu: (qesh) I keni ndjekë koncertet atëhere edhe tash sot muzika është shumë ma e qasshme se sa që ka qenë atëhere, për shkak se koncerti atëherë ka qenë diçka që të ka pëlqy me shku se s'ka qenë muzika qaq e qasshme, a e vreni qet dallim?

Veton Nurkollari: Po, edhe a din çka vërej, çka po më pengon në fakt prej gjithë kësaj qasshmërisë muzikës është që pak po ngoj ma pak muzikë. Prej gjithë internetit, e Youtube, e Spotify, e mundësisë së hatashme me ndëgju muzikë, une në fakt po ngoj shumë ma pak muzikë. Nuk e di qysh me skjaru, a është qasshmëria ajo a kanë ndryshu senet tjera, ndoshta unë s'kam kohë të mjaftushme e tash po ja gjoj behanën kështu. Po përpara kam ndëgju shumë, shumë, shumë ma shumë. Kohën e lirë nëse s'kam bo diçka unë kam ngu muzikë. *Walkman*⁶, kur ka dalë *walkmani* i parë, kam qenë i hallakatëm, i tranum kur e kam marrë *walkmen*-in e parë. Si, si, si me pasë kerr. Me mujt muzikë me veti, {prek xhepin e pantollonave} me hecë, andrra e hatashme. Ipod-in e parë e kam porosit menjëherë sa ka dalë. Ka qenë diçka e jashtëzakonshme me pasë muzikë me veti edhe me mujt shlrë me hecë edhe {tregon veshët}. Po tash s'po ngoj aq shumë, nuk e di a është veç puna e qasshmërisë a jam unë i preokupum me sendet tjera, apo nuk kam kohë, apo po kqyri ma shumë filma, ma pak muzikë, me gjasë qajo osht', po s'po di.

Aurela Kadriu: A keni mbërri ndonjëherë me bo balancin mes filmave dhe muzikës?

Veton Nurkollari: S'di tash po ngoj muzikë veç në momente. Kur po jom disi i disponum për muzikë atëherë nuk boj kurgjo tjetër, as nuk kqyri filma, as, më kaplon disi edhe i kam do momente kur prapë zhytem ose kthehem mrapa në njëfarë ekzaltimi me muzikën. Po pak osht' ajo në krahasim me sa kam... shumë ma shumë kam ndëgju muzikë, shumë ma shumë. Në punë, {numëron në gishta} në kerr. Gramofonin unë e kam pasë në lokal, në qat' nivel e kam pasë nevojën për muzikë, sa që komplet një pjesë të pllakave edhe gramofonin e pata instalu në lokal aty edhe kur s'kam pasë myshteri une ngojsa muzikë prej pllakave.

Aurela Kadriu: Më tregun Andrra dhe Aneta që keni jetu pak në Londër.

Veton Nurkollari: Shumë pak (buzëqesh).

Aurela Kadriu: Qysh ka... pse, pse u kthyt ma s'pari, pse keni vendos me nejt në Prizren?

Veton Nurkollari: Nji herë po të tregoj pse kam vendos me shku (qesh) në Londër.

Aurela Kadriu: (qesh) Okej, qaty po ja nisim.

⁶ Medium portativ i prodhuar nga Sony. Për herë të parë i lëshuar në treg në vitin 1979, një mjet ku futeshin kasetat dhe njerëzit mund t'i dëgjonin ato edhe kur ishin në lëvizje.

Veton Nurkollari: Është moment kështu i randësishëm në jetën time dhe të Zelhës. Kur u martum na vendosëm mos me jetu këtu edhe çka do të bojna, ku do të jetojna? Thashë, “Kena me shku në Londër” edhe na shkum në Londër edhe “Çka të bëjmë në Londër?” E gjetëm njëfarë pune edhe une edhe ajo po nuk ke ai ritmi i jetës atje, ajo, ajo njëfarë presioni i punës ke tepër diçka edhe njëfarë jo rahatie se çkado që fitojsha i harxhojsha në qira për banesë, për rrymë e për... në fakt s’fitojsha kurgjo hiç. E sa për ashtu vendosa, thashe⁴ sa për ashtu apet kthehem unë në Kosovë. Ndoshta dikun ma vonë me atë, njëfarë mendje hajt të kthehem, të shkoj pak në Kosovë pastaj prapë kthehem në Londër. Edhe pse fillimisht shkum për...

Aurela Kadriu: Me nejt.

Veton Nurkollari: Me nejt edhe me jetu aty edhe u vendosëm edhe... po pak.

Aurela Kadriu: Cili vit ka qenë?

Veton Nurkollari: ‘91 nëse s’jam gabim. Ose ‘90 ose ‘91. Menjëherë në fillim të ‘91.

Aurela Kadriu: Po du m’u kthy prape te vendi në të cilin jemi edhe mandej, mandej dalim kështu te të ‘90-tat si periudhë. Jemi në Lumbardh edhe po kom qef veç me na tregu se çka është Lumbardhi për juve? Çfarë kujtime keni në këtë vend? Edhe çka është për Prizrenin sipas jush Lumbardhi?

Veton Nurkollari: Për mu po besoj edhe për shumë njerëz të tjerë sidomos gjeneratës time, a ndoshta edhe për disa gjenerata edhe ma të vjetra se une edhe ma shumë, është vend ikonik, është vend... nuk e di me çka me e krahasu. Thashë edhe ma herët na nuk kemi pasë shumë vende për me dalë këtu, një prej vendeve ku kemi dalë ka qenë këtu {tregon me gisht në tokë} edhe njëfarë ritmi i daljes ka qenë në kinema mandej në qytet, jo anasjelltas. Domethanë, kemi dalë, kemi pa naj film, mandej kemi dalë në qytet, sidomos verës. Dimrit ajo pak ma ndryshe ka qenë, po rregullisht kemi ardhë këtu, për shkak që rregullisht ka pasë filma interesant edhe në këtë qytet s’ki pasë shumë sene çka me bo. Tek kafiqat e parë kanë nisë m’u hap në fillim të ‘80-tave, por jo në këtë numër çfarë ka. Dy-tri kafiqja je endë prej një kafiqi në tjetrin, shpejt ka nisë ajo m’u bo monoton. Njerëzit e njëjtë t’u nejt në vende të njëjta, muhabetet e njëjta.

Mu më ka interesu shumë filmi edhe kam ardhë shumë këtu, edhe këtu edhe në atë kinemanë tjetër, të dytë i kam frekuentu mjaft shumë. Kam shumë kujtime prej... disi jam eduku, njëfarë edukate të filmit kam marrë këtu edhe pse s’kam ditë atëherë, nuk është që më ka interesu kështu me analizu filma sene. Po i etshëm për një lloj të artit edhe ka qenë një art që ka qenë mjaft afër asaj se çka kom pasë une në familje. Se babën fotograf edhe njëfarë ngjashmërie e fotografisë edhe filmit edhe krejt ajo m’u ka dokë disi natyral. Edhe krejt shoqnia jeme krejt kanë qenë do merakli të filmit, kështu që kena ardhë shpesh, nuk ka pasë ndonji tash dikush m’u anku, “A pse po shkojmë në filma?” Shkojshim na në filma, kena ardhë me pa filmin edhe herën e dytë, edhe herën e tretë edhe, edhe...

Si pram, para dy-tri netëve ishte njëfarë emisioni në televizion e pash për, për, për ditën kur ka vdek Tito. Edhe m'u kujtu mu ajo ditë {prek kokën me gisht} edhe m'u kujtu pse, një prej arsyeve pse më kujtohet ajo ditë është që u mbyll ky vendi {tregon me gisht tokën} (qesh). U mbyll për shkak ditë zie, e mbajtën ato ku e di një javë a dy javë edhe e hekën prej repertoarit filmin *Saturday Night Fever*, e na shkojshim me pa *Saturday Night Fever* çdo ditë se dojshim me mësu qysh po lun John Travolta (qesh). Që me mujt ndoshta edhe na me lujt ngjashëm si John Travolta, si lektyrë na ishte edhe vdiq Tito edhe bash në qat' periudhë filmi ka qenë në repertoar edhe natyrisht e hekën, e ndalun se s'ka qenë... e ndalume, duhesh me majt zi aty një javë, dy javë nuk e di sa (qesh). Po momente kështu interesante të lidhuna me, me këtë vend.

Aurela Kadriu: Po, të '90-tat qysh ju afekton juve ajo që ndodhi në mbarë të '90-tat?

Veton Nurkollari: Të '90-tat ja nisi si plot sene tjera këtu, njëfarë kështu s'po di qysh me kujt, po kështu njëfarë *downward* [anglisht - teposhtëze] spirale {e lëviz dorën ngadal poshtë} t'u shku t'u bo ma keq, ma keq e ma jo qasshëm. Bile, bile, deri në atë moment që ty nuk të vike mo merak me ardhë këtu [në Lumbardh], njëfarë segregacioni i çuditshëm ja nisi me ndodh. Ja nisën fillimisht me pru filma, ma shumë filma jugosllav, diçka sërbe. E normalisht, prej filmave erotik ja nisi kinemaja m'u shnëdrro në filma pornografik edhe një periudhë kanë lëshu filma ashiqare, domethanë pornografik filma në pikë të ditës edhe ajo nuk e di unë. Ashtu në kinema ti ki nëpër qytete të mëdha, diku në periferi {tregon me dorë pas vetes}, najfarë rrugice, por jo në qendër të qytetit edhe jo në kinemanë e vetme. Por ajo nuk ka ndodh vetëm këtu, ka qenë një, një, një si me thonë njëfarë, njëfarë ere e shkatërrimit që e kaploi jo vetëm kinemanë por edhe fushat tjera.

Edhe një prej elementeve ka qenë shmangia prej kështu t'i quaj filmave normal {me gishta bën thonjëza} ose të repertoarit normal edhe, edhe njëfarë *switch*-i [anglisht - ndryshim] kadal-kadale në distribucion edhe kinema pornografik. Edhe na ja nisëm ngadal-ngadalë me ndërpre me ardh se nuk është që na interesojke me ardh midis qytetit me 700 njerëz me kqyr filma pornografik (qesh), diçka totalisht banal. Edhe në atë moshë, a din, nuk e di çfarë ndjenje osht' ajo, mundesh me kqyrë pornografi ndoshta si shumica nejrëzve që kqyrin në dhomën e vet, por jo me 100 njerëz, 200 njerëz (qesh), është diçka me të vërtetë... Një herë, dy herë kam pa edhe m'u ka dokë diçka total absurd, thashë, "Qysh mundet ajo?" Edhe ajo ja nisi qashtu ta them një spirale teposhtëze derisa u mbyll mo. U mbyll edhe pak para luftës s'jam sigurt sakt kur o mbyll, qysh o mbyll, po diçka para luftës mo ja nisi mos me punu fare.

Aurela Kadriu: E qysh e keni përmbush qat' boshllëkun që ju ka kriju fakti që mo Lumbardhi s'ka qenë pikë reference për juve?

Veton Nurkollari: Po a din qysh ato vitet para, qysh me thonë vitet e zymta, fundi i '90-tave, prej '95 ose tutje nuk jam i sigurt më, duket gati edhe që kom hup memorjen se çka kena bo na. Njëherë e di që

ka ekzistuar njëfarë ore policore, që na u mbyllshim në shtëpi, diku prej orës pesë apo gjashtë masdite e deri në mëngjes ti s'ke muj me dalë, ashtu që badihava që ka punu kjo. Nëse ka punu, na s'kemi mujt me ardhë me dalë. Ashtu që, çka më kujtohet e kam pasë një bicikël për pesë minuta, para pesë {prek dorën për të treguar orën} vrap në shtëpi mos me t'rrok ora policore, mos po t'kap naj polic e plus dajak, plus... qeto jonë senet, po komplet ajo ka qenë njëfarë zyrtësie t'u shku tu u bo ma keq e ma keq e dej sa, dej sa erdh lufta.

Aurela Kadriu: A e mbajshit dyqanin çelë në këtë kohë, a ka qenë...?

Veton Nurkollari: Po. Po, po e mbajshim.

Aurela Kadriu: Në çfarë kushte?

Veton Nurkollari: Po, në qato kushte e mbajshim. Para atyne kushteve ka qenë, ka qenë periudha e hiper inflacionit e ato kanë qenë do, do, do, do, do vite kështu kushtimisht {bën me gishta thonjëzat} t'i quaj tepër interesant, ku ti çkado që ke bo ka qenë ose sado që ke fitu u dashtë ato menjëherë me i shndërru në një valutë të fortë e qujshin, marka, dollarë e sene, por jo m'i lonë dinarë se {përplas duart} i hupshe. Ka qenë njëfarë çmendurie kështu (qesh) me jetu me hiperinflacion, ku kushtojshin senet me miliona, me miliarda, me... E ato paret s'kanë pasë kurrfarë vlere, u dashtë menjëherë, menjëherë me i shndërru në marka. Secili prej neve e ka pasë dikend që i ndrojkë ato paret.

Aurela Kadriu: Shfercera.

Veton Nurkollari: Po, shfercerat e mule vrap te shfercerat. Qato çka i ke fitu 20 marka, 20 marka ndërroji boni marka se mete.

Aurela Kadriu: Dollarë?

Veton Nurkollari: Dollarë, e marka e... Po s'di të '90-tat kanë qenë tepër, një dekadë shumë, shumë (qesh), shumë interesant.

Aurela Kadriu: A ka pasë najfarë lëvizje siç ka qenë në Prishtinë, mujm me diskutu, sikur në Prishtinë me siguru rezistencë paqësore, a ka pasë në Prizren qashtu diçka, najfarë grupi që janë mundu me majt artin, kulturën kundër represionit?

Veton Nurkollari: Pak.

Aurela Kadriu: A keni pasë najfarë shpije, najfarë...?

Veton Nurkollari: Pak, jo shumë. Për sene të mira unë kam udhëtu prej këtuhit në Prishtinë (buzëqesh). Çkado interesant diçka kam hyp në kerr kam shku në Prishtinë, se nuk ndodhke shumë sene interesant në Prizren. Prizreni pak ma i tërhjekun e natyrisht ka pasë rezistencë, ka pasë qysh me thonë lëvizje *underground* [anglisht - nëntokësore], lëvizje për me mbledhë të holla me i ndihmu shkollat sendet, krejt ajo çka ka pasë në Prishtinë, ka pasë edhe në Prizren sendet, krejt ka qenë disi e lidhur. Po sa i përket artit ma pak.

Aurela Kadriu: E në Prishtinë ku keni shku të '90-tat?

Veton Nurkollari: Në Kurriz (buzëqesh).

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë Kurrizi për juve?

Veton Nurkollari: Super! (qesh)

Aurela Kadriu: A keni naj kujtim, bash po më intereson, diçka qysh e, qysh e kujtoni Kurrizin, të '90-tat?

Veton Nurkollari: Si Nju Jork m'u doke Kurrizi me të kallxu t'drejtën. Une kur visha në Kurriz si Nju Jork me shku, m'u doke super interesant. Thojsha, "Pse në Prizren s'ka një Kurriz, ndonji vend ku..." shumë *underground* m'u doke. Bauhaus ka qenë një kafiq i jashtëzakonshëm qaty në hymje para se me hi te, përpara kanë qenë do dyrë të hekrit {shpjegon me duar} e para se me ardhë te dyrtë e hekrit në anën e majtë ka qenë një kafiq kështu krejt i zi, terr, me muzikë super, emrin e ka pasë Bauhaus edhe une prej ktuhit shkojsha në Bauhaus sidomos, po edhe do kafiqa tjerë aty. Atmosfera nëpër kafiqa në Kurriz ka qenë shumë ma e mirë se në Prizren.

Në Prizren i ke pasë do kafiqa që kanë qenë si do ujdhesa aty-këtu njo aty-këtu, i vetmi vend i mirë deri diku i mirë {tregon me dorë djathtas} është një vend që është qujt si Qylani Vjetër ose ku ka qenë Dyshi e një rend i kafiqave, po i cili në një moment, për një moment të shpejt u prish total edhe diku ka mesi i '90-tave diku u prish keq edhe kurgjo mo s'funksionojke. Kështu që, une edhe plot do njerëz tjerë këtu s'kishim vend ku me dalë edhe kur dilshim kanë qenë shumë, shumë të njejtë disi. Kështu që, shpesh shkojsha në Prishtinë për shkak se Kurrizi m'u doke, shumë, shumë interesant. Edhe vetëm Kurrizi se vendet e tjera në Prishtinë s'osht' që ka pasë diçka shumë interesant, po Kurrizi e ka pasë një atmosferë të hatashme një kohë, jo tanë kohën, po për një kohë tepër më ka pëlqy.

Aurela Kadriu: Ku keni qenë gjatë luftës, keni qenë këtu a në Shipni?

Veton Nurkollari: Gjatë luftës veç nja ni javë, javën e parë kam qenë këtu, mandej e gjeta njëfarë mundësie me dalë në Maqedoni, mandej krejt luftën kam qenë në Tetovë. Por shumicën e kohës kam punu me një kamp të refugjatëve në Stankovec për një organizatë edhe kam udhëheq njëherë një

çerdhe të madhe të fëmijëve, mandej edhe një tjetër. Kështu që, kam qenë njëfarë përgjegjësi për dy çerdhe të fëmijëve (buzëqesh). Për Save the Children kam punu edhe në ditën e parë me, momentin kur ushtria, NATO edhe gazetarët kanë hi, kanë ardhë në Kosovë, unë jam kyç në një ekip të gazetarëve të Gjermanisë edhe kam ardhë këtu në Prizren, natën e parë aty. Ka qenë tepër një moment emocionues me u kthyer në qytet.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë masë luftës kur jeni kthyer, qatëhere kur jeni kthyer në Prizren?

Veton Nurkollari: Krejt në fillim, qato ditët e para ka qenë një eufori e jashtëzakonshme, eufori që kurrë në jetë s'e kam përjetu edhe nuk ma merr menja që e përjetoj ku me ditë edhe sa jeta me i jetu. Nji, nji... nuk e di, diçka në ajër ka qenë, njerëz të gëzushëm, njëfarë miksi i i gëzimit të madh, por edhe njëfarë rreziku që ende ekzistojke. I përzim disi, njerëz, njëfarë tollovie, hallakame. Une punojsha me një ekip të televizionit gjerman, ashtu që më ka ra rasti me intervistë me me... Po mu më ka ra pak me dalë edhe jashtë Prizrenit, nëpër do fshatna, edhe në Gjakovë edhe në Pejë edhe me i pa shkatërrimet edhe vendet e masakrave, seneve, kështu që i kom do, do momente që nuk janë bash të kandshme. Por, nejtë, në përgjithësi ajo që mbaj mend ma së shumti është njëfarë euforie e hatashme të njerëzve në ajër edhe ni diçka që s'ma merr mendja që përsëritet.

Aurela Kadriu: Ju personalisht shpinë a e keni, a keni pas dëmtime në shpi?

Veton Nurkollari: {pin ujë} Edhe pse na dulëm prej, prej shtëpisë për shkak që kena pasë frikë që do të ketë dëmtim se shtëpia jeme osht' gati e ngjitur, pak dhetë metra prej objektit që tregova, objekti, ish-objekti i ushtrisë, i oficerëve të ushtrisë të Jugosllavisë edhe menjëherë me ditën e parë të bombardimeve, menjëherë ja nisën thashethemet se një prej caqeve [të NATO-s] do të jetë ai vendi. Ashtu që, na një natë vetëm kena nejtë në shtëpi edhe të nesërmen qashtu krejt familja shkum te ni shok i ngushtë, u zhvendosëm në pjesën tjetër të qytetit edhe i kalum disa ditë te ata e mandej bashkë, bashkë dulëm. Dikush na lajmroi që ekziston njëfarë gjase me kalu në Maqedoni edhe dulëm pak para se të ndodhë Bllaca. Ndoshta një dhetë orë, dy dhetë orë diçka, metëm na në Bllacë por dulëm disi {sikur shtyn diçka duar}, metëm një 10-15 orë në Bllacë po na lëshun maqedonët.

Mandej dëgjova... mandej ja nisa me punu në Stankovec e i dëgjojsha storjet e njerëzve se si kanë mbetë në Bllacë edhe ka qenë shumë lehtë me mbetë aty, se njerëzit kanë mbetë. Kanë ardhë deri aty, po kanë mbetë. Mandej u kriju ajo rrëmuja e madhe e Bllacës. Po jo s'ka ndodhë diçka, nuk ka ndodhë as në lokal, as në shtëpi. Po më duhet me thonë që shumë pak ka ndodhë në Prizren. Prizreni është shkatërru ma vonë, vetëm një pjesë e vogël e periferisë së Prizrenit ka pësuar dëmtime prej luftës, mandej një pjesë tjetër është shkatërru në vitin 2004. Në krahasim me qytetet tjera, sidomos une kur kom shku në Gjakovë prej Prizrenit edhe kur kam qenë në Pejë, ajo u konë tmerr. Tek atëherë kam pa se çfarë fati ka pasë qyteti i Prizrenit me, me pshtu.

Aurela Kadriu: Për trazirat e 2004-shit e keni fjalën a po?

Veton Nurkollari: Po mandej trazirat e 2004-shit është shkatërru një pjesë {tregon me dorë kahjen} e, e nënkalasë e janë djeg plot do shtëpia. Prizreni, domethanë, një shkatërrim i Prizrenit në fakt ka ndodhë në 2004, jo '99-tën.

Aurela Kadriu: Kisha pasë qef tash me diskutu ma gjatë se s'pe di, a ju kom pa najherë që keni folë se qysh, se qysh është ideu Dokufesti? Qysh ka nisë, ka ka ardhë ideja për Dokufestin, s'e di a kemi folë najherë, a kemi lexu najherë për këtë pjesë?

Veton Nurkollari: (qesh) Nuk ma merr menja, se nuk e di që dikush prej neve ka folë kështu. Me siguri është folë ose, ose nga ana ime ose nga ana tjetër kujt, po une muj me t'kallxu pjesën time të tregimit për shkak që ekzistojnë edhe do, do, do nijansa tjera. {pin ujë} Du me t'kallxu qysh kam ardhë une aty. Mu më ka ftu Ali Riza, një ditë më ka ftu me bisedu diçka tha, "Hajde" tha "ta pijmë nga një birrë kam diçka me me folë me ty, a je i interesum" edhe ja nisi me folë për një festival tha, "Çka po ta merr mendja? A kishe qenë për?" Po ja nisi me folë për festival të muzikës (qesh). Qaty më intereso i ma tepër, sesa për film. Shpejt muhabeti u kthy në festival të filmit, po fillimisht kemi bisedu për, për ni diçka që ka të bëjë me muzikë. Po, shpesh thom shumë naiv kena qenë, jo naiv po qaq sa kena qenë naiv, kena qenë edhe kena besu që bon me bo diçka për shkak që krejt muhabeti mandej u kthy në Lumbardh edhe iniciativa me bo diçka përfundojke me njëfarë aktivizimi të Lumbardhit.

Nuk kena pasë na ndonji ide madhore, ndonji vizion që mas 15 vjetve, 20 vjetve do të bohet najfarë festivali i madh. Na çka kena dashtë me bo ka qenë me aktivizu këtë vend, kena besu disi që nëse ndodh diçka edhe shfaqen filma, ndoshta vetvetiu ja nisë punën kinemaja edhe na e kena përfundu {në grit duart}. Na kur e bonëm edicionin e parë harrum na që duhet me bo prapë, për me bo prapë kanë nisë njerëzit me na nguc, "Hej kur keni me bo, qysh keni me bo? Mirë ke ajo". Për shkak që ne edicionin e parë e bonëm pa, pa kurrfarë pare, të vetmin, të vetmin buxhet që e kena pasë ka qenë 2500 marka të SOROS-it, i vetmi buxhet edhe diçka kemi shtu na aty-këtu sa na u ka dashtë diçka. Krejt ka mujt me kushtu nja, hajt të them nja katër mijë marka s'ma merr mendja ma tepër. Edhe kur, kur u kry nuk kena pasë na ndonji ambicje me bo edhe njo.

Njerëzit, shokët, qeta njerëzit e qytetit ja nisën me na, me na... qysh me thonë, me na prek kapak me thonë, "Hej, kur doni me bo ato, mirë ke". Mos kish qenë kjo prej njerëzve të tjerë ndoshta, ndoshta edhe nuk e kishim bo edhe një edicion. Mandej në edicionin e dytë u, u bo pak ma serioz, edhe këto e përsëris shpesh une, edicionin e parë, të dytë tash nuk e di për të tretin. Por, dy edicionet e para jam i bindur asnjë prej neve që kena bo festivalin s'kena qenë asnjëherë në festival të filmit përpara. Të parin e di qind për qind që njerëzit që e kanë nisë festivalin qaq pa eksperiencë kemi qenë, sa që asnjë prej neve s'ka qenë para asajna në asnjë festival të filmit.

A po kupton, ti çohesh me bo diçka vetëm me njëfarë imagjinate se si duhet me u dukë ajo, mirëpo kurrfarë reference nuk kena pasë, tek mandej ja nisëm me udhëtu kapak, dikush na tha, tha, tha, "A

doni me shtyp ju katalog? Se” tha “nuk bon me qenë festival i filmit pa katalog”. Ashtu që, na tek në edicionin e tretë shtypëm katalog. Na sot e kësaj dite nuk kena katalog të të edicionit të parë edhe të dytë, sepse nuk i kena shtyp as nuk kena ditë se si bahet katalogu. Na u dashtë me udhëtu, me pa, me sjellë diçka edhe mandej ato pak me kopju, pak me... Po qishtë, ka qenë njëfarë iniciative e njerëzve kështu pa ndonji ambicje madhore atëherë, më duhet prapë me me me përsëritë. Mandej natyrisht ajo nisi kadal-kadale m’u zhvillu e m’u, na me msu kapak me pa çka janë gabimet e mandej ja nisëm me dalë prej një vendi në vend tjetër.

Nja dy vjet nuk na ka dhonë leje komuna atëherë me, me vendos edhe një kinema të hapun {me gisht tregon djathtas} në pllanton ku është tash, nuk na jepke. Unë vet kam shkuar për të biseduar me nënkryetarin e komunës, e prita nja ni orë derisa më pranoi edhe në fund nuk m’pranoi, në fund më tha, “Duhet me prit”. Prita nja ni orë edhe në fund i dul njëfarë pune edhe nuk m’pranoi edhe pse pata caktu edhe nuk na dha. Edhe pse nuk lypshim kurgjo, vendin, po qishtë ka qenë atëherë. S’kanë besu shumë, fonde s’kena pasë prej institucioneve, po nuk e di, së paku nja pesë vjet të para.

Aurela Kadriu: Çka keni qenë t’u bo qatëherë kur e keni marr ftesën prej Ali Rizës, keni qenë në lokal a?

Veton Nurkollari: Po, po, kam punu, kam punu si fotograf.

Aurela Kadriu: E di që keni qenë të përfshim edhe në fushatën për mbrojtjen e Lumbardhit. E di që po kthehemi shumë rreth Lumbardhit po edhe jeta ju njëfarë forme lidhet me Lumbardhin shumë.

Veton Nurkollari: Po, Lumbardhi. Thashë që një prej arsyeve kryesore pse e kemi nisë atë festival në fakt ka qenë Lumbardhi edhe shumë shpejt kuptum që Lumbardhi është fut në listën e Agjencisë për Privatizim edhe që mund të shitet apo të shndërrohet në ku me ditë çka. Na e nisëm një iniciativë, tash nuk jom i sigurt po është dashtë me qenë viti 2004, është iniciativa e parë për mbrojtjen e Lumbardhit. E bëmë një petition, i mbledhëm rreth tetë mijë nënshkrime, prodhum disa fletushka, postera, e animum... sidomos këtu në qytet por edhe, edhe jashtë qytetit për nevojën për me mbrojt këtë vendin edhe për mos m’u shit. Edhe mendoj që ajo ka qenë njëfarë iniciative e suksesshme deri me një moment për mos me u privatizu menjëherë.

Unë mendoj që ai ish-kryetari i komunës i atëhershëm i cili ka qenë iniciator për me, për me rrëzu këtë vend, ka bo një gabim të hatashëm që i ka kushtu shumë edhe atij {numëron në gishta}, edhe partisë, edhe karrierës tij politike, për shkak që mas disa mujve i ka hup zgjedhjet për, për Kryetar të Komunës edhe ka bo një gabim që normal nuk bohet para fushatës. Se me siguri nuk ka mendu që mund të mobilizohet një masë kritike kaq e madhe edhe qajo masë kritike mandej mundet m’i kushtu atij me vota, që unë mendoj që i ka kushtu. Gati gabimin e njëjtë e ka përsëritë edhe ish-kryetari i Prizrenit i cili prapë, jo ai po, po partia e tij i kanë hup zgjedhjet për shkak që ekziston një sentiment i

jashtëzakonshëm i qytetarëve të Prizrenit për këtë vend edhe po më vjen keq që nuk e kanë kuptu ose disa e kanë kuptu, disa nuk e kanë kuptu.

[Këtu ndërprehet intervista]

Po nëse nuk gaboj është viti 2015 edhe disa javë para se t'ja nis edicioni Dokufest, ne kuptuam që Agjencioni për Privatizim i Kosovës e ka fut Lumbardhin në listën e aseteve për shitje që ka qenë edhe një hap, mos ta quaj i gabueshëm por për neve i rrezikshëm edhe në atë moment kemi vendos që konceptin edhe temën edhe krejt të festivalit e sidomos konceptin e hapjes së festivalit ta ndryshojmë komplet, tërësisht. Edhe në vend se një hapje që e kemi parapa e bëmë një hapje në formë të protestës ku unë e lexova një tekst të shkruar nga Shpat Deda së bashku me, me rreth 50 vullnetarë {tregon pas vetes} apo ma shumë një tekst të inspiruar prej Occupy New York. Edhe mas asaj e shfaqëm edhe filmin pak a shumë që ka të bëjë me edhe Occupy New York edhe me mënyrat tjera të rezistencës paqësore. Kemi dashtë me tregu që nuk pajtohem asesi edhe natyrisht kemi ftu edhe aleatë tjerë, qytetarë edhe të gjithë ata që mendojnë sikur na që të na bashkohen për me mbrojt Lumbardhin. Edhe na u bashkun 57 organizata të shoqërisë civile prej krejt Kosovës për një apel që të hiqet Lumbardhi nga lista e aseteve për shitje.

Aty ndodhi, ndodhën disa sende, një ishte paraqitja e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama në mbyllje të atij edicioni me një porosi për kryetarin e komunës i cili ishte prezent në mbyllje, se “Kryetarët vijnë e shkojnë, po nëse Dokufesti shkon apo nëse Lumbardhi shkon atëherë nuk kthehet”. Edhe mendoj që ka qenë një porosi të cilën fatmirësisht e kanë kuptu edhe kryetari i atëhershëm i Komunës së Prizrenit. Ai ka bërë një prej sendeve të rralla të mira që e mbaj në mend unë e që ka inicuar shpalljen e e Lumbardhit si, si monument të randësisë të veçantë apo diçka ngjashëm në asamble të Prizrenit e që mandej ka vazhdu me një, me një iniciativë që vazhdon edhe deri sot, deri te, deri te, shpallja nga ana e Qeverisë së Kosovës, të heqjes së Lumbardhit komplet nga lista e e Agjencisë për Privatizim edhe kthimit në pronësi të Komunës së Prizrenit.

Mendoj se është një fitore e jashtëzakonshme e shoqërisë civile edhe e iniciativës edhe uroj që prej këtu e tutje Lumbardhi të kthehet edhe të bëhet një qendër për art, kulturë dhe për rini, ashtu siç në fakt është pararendur edhe qysh është t'u shku. Unë mendoj që së shpejti do të ketë lëvizje edhe shumë ma të mira sa i përket Lumbardhit.

Aurela Kadriu: Çka vazhdoni sot me bo përpos atyre dy javëve që ju shohim shumë në Dokufest?

Veton Nurkollari: Puna jeme në Dokufest kryesisht ka të bëjë me pjesën artistike, sidomos me programin e festivalit. Ashtu që, një, një pjesë e konsiderueshme e kohës time i shkon asaj. Udhëtoj mjaft, kështu që udhëtoj nëpër festivale tjera, shpesh më ftojnë qesi antar të jurisë. Kështu që, m'ka ra me udhëtu mjaft. Provoj me i imagjinu edicionet tjera se si doken edhe çka duhet me bo edhe, edhe... Po përveç asaj, gjatë, gjatë tanë vitit na punojmë edhe në disa projekte të randësishme që kanë të

bëjnë me edukim edhe ma shumë e ma shumë jemi të orientum në, në, në edukim nëpërmjet filmit. Kështu që, kemi inicu rreth 20 klube të kinemasë nëpër shkollat fillore dhe të mesme nëpër krejt Kosovën.

Jemi në proces edhe të krijimit të një manuali për arsimtarë se si duhet të përdoret filmi jashtë kurrikulës. Po ashtu jemi në proces të krijimit të një databazës rreth 50 filmave edhe klipave nga ata filma e që janë bazë për arsimtarët, përkthime, pyetësor e kesi sene. Që është një trend në shumë vende të botës e që mendoj edhe këtu do të ketë sukses, për shkak që është inovativ edhe mundëson, mundëson një qasje ndaj shumë lëndëve, qofshin histori, sociologji e, e gjuhë edhe me përdorë pjesë të filmit në vend se dërrasës zezë apo një profesor i cili, i cili vetëm spjegon në një mënyrë që po më doket veç arkaikë e që teknologjia edhe avancimi tash e mundëson. Jemi tu kriju një department komplet në Dokufest i cili po mirret me, me edukim.

Aurela Kadriu: Nëse s'keni diçka me shtu veç ju kisha falenderu shumë për kohën.

Veton Nurkollari: Ju falenderoj për mundësinë!